



STUDIMI I MBIKËQYRJES SË INTEGRUAR TË SJELLJEVE DHE BIOLOGJIKE PËR HIV – KOSOVË, 2014

**Personat që injektojnë drogë në Prishtinë dhe Prizren
Meshkujt që bëjnë seks me meshkuj në Prishtinë**

With the financial support of



Anëtarët e grupit referent për studim të mbikëqyrjes së integruar të sjelljeve dhe biologjike

Anëtarët e grupit referent të studimit Ardita Tahirukaj, OBSH, Alban Gjonbalaj, Asociacioni Kosovar për persona që jetojnë me HIV (KAPHA), Luljeta Gashi, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike dhe Edona Deva, Community Development Fund (CDF).

Financimi dhe institucionet e përfshira

Ky studim, përfshin hulumtimin formativ dhe është financuar nga Fondi Global për luftimin e HIV/AIDS, Tuberkulozës dhe Malaries (FGATM). Asistenca teknike, përgatitja e protokollit të studimit, trajnimi për RDS, analiza dhe përgatitja e raportit përfundimtar është financuar nga FGATM përmes CDF në Prishtinë, Kosovë.

Asistenca teknike dhe përgatitja e raportit

Asistenca teknike gjatë grumbullimit dhe analizës së të dhënave si dhe përgatitja e raportit është bërë nga Lisa G. Johnston, University of California, San Francisco, and Tulane University, School of International Health and Tropical Medicine, Louisiana, (lsjohnston.global@gmail.com, www.lisagjohnston.com) me financim nga FGATM. Ndërsa, grumbullimi i të dhënave, analiza dhe përgatitja e raportit në vend është bërë nga Xhevat Jakupi, Dafina Gexha-Bunjaku, Pranvera Kaçaniku-Gunga, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHPK) dhe Edona Deva, CDF.

Mirënjohje

Falënderojmë të gjithë ata që kanë marrë pjesë në këtë studim si dhe përkrahjen që kemi pas nga organizatat joqeveritare, Labirinti në Prishtinë dhe Prizren dhe Qendrën për Zhvillim të Grupeve Shoqërore (CSGD) në Prishtinë.



CSGD

Stafi i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike:

Dr. Xhevat Jakupi, Koordinator

Dr. Dafina Gexha - Bunjaku, Menaxhere e të dhënave dhe asistente e koordinorit

Dr. Pranvera Kaçaniku - Gunga, Zyrtare për futjen e të dhënave

Dr. Arsim Kurti, Mikrobiolog

Avdyl Lokaj, Zyrtar i financave

Ilir Gllasoviku, Zyrtar i administratës

Florim Ahmeti, Teknik laborant

Sevdie Ahmeti, Teknik laborant

Ali Sutaj, Vozitës

Pehlivan Hoxha, Vozitës

Ekipi për PID Prishtinë

Intervistuesit: Brikena Krasniqi, Dafina Muçaj
Menaxher i kuponëve dhe skrinues: Vigan Blakaj
Laborant: Ervin Hysenaj
Mbikëqyrës: Safet Blakaj

Ekipi për PID Prizren:

Intervistuesit: Kaltrina Skoro, Arta Musliu
Menaxher i kuponëve dhe skrinues: Alban Veliu
Laborant: Elvira Karabaxhak
Mbikëqyrës: Eroll Shporta

Ekipi për MSM Prishtinë:

Intervistuesit: Agim Margilaj, Ragip Salihu
Menaxher i kuponëve dhe skrinues: Besnik Bllaca
Laborant: Gjejverije Gjonbalaj
Mbikëqyrës: Nazmi Gashi

SHKURTESAT/ AKRONIMET

CSGD	Centre for Social Group Development
PSF	Punëtore e seksit femër
FGATM	Fondi Global për luftimin e AIDS, TB dhe Malaries
HIV	Human Immunodeficiency Virus
MISB	Mbikëqyrja e integruar e sjelljeve dhe biologjike
SISB	Studimi i integruar i sjelljeve dhe biologjik
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
MSM	Meshkujt që bëjnë seks me meshkuj
OJQ	Organizatë joqeveritare
VMP	Vlerësimi i madhësisë së popullatës
PID	Personat që injektojnë drogë
MDR	Mostrimi i Drejtuar nga Respodenti
IST	Infeksione seksualisht transmissive
KTV	Këshillimi dhe testimi vullnetar
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
CDF	Community Development Fund

PËRMBLEDHJE

Ky raport paraqet të gjeturat nga studimi i tretë me radhë për mbikëqyrjen e integruar të sjelljeve dhe biologjike (MISB) në mesin e personave që injektojnë drogë (PID) në Prishtinë dhe Prizren, si dhe në mesin e meshkujve që bëjnë seks me meshkuj (MSM) të kryer gjatë muajve korrik, gusht dhe shtator të vitit 2014. Objektiva kryesore e këtyre studimeve ishte të ofrojë informata për prevalencën e infeksionit me HIV dhe infeksioneve tjera seksualisht transmise (IST) dhe faktorët e rrezikut për t'iu ofruar të dhëna programeve dhe politikave për reagim dhe të përcaktoj periudhën kohore për monitorimin e trendit të epidemisë.

Studimi i tretë me radhë MISB të HIV në Kosovë është financuar nga FGATM përmes Community Development Fund (CDF), Prishtinë, Kosovë dhe është implementuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHP), Prishtinë, Kosovë. Financimi dhe përkrahja teknike e studimit është siguruar nga FGATM përmes CDF.

Studimet e PID dhe MSM janë bërë përmes mostrimit të drejtuar nga respondentit (MDR) ku mostra ka qenë 300 PID në Prishtinë, 199 PID në Prizren dhe 217 MSM në Prishtinë gjatë periudhës kohore korrik-shtator 2014. MDR është metodë e mostrimit përmes referimit zingjirë e dizajnuar në mënyrë specifike për të arritur mostrën e bazuar në probabilitet të popullatave 'të fshehura' ose vështirë të arritshme që janë të lidhura me rrjetet social. Pas dhënies së pëlqimit, respondentët janë intervistuar dhe iu [sht] marr[mostra e gjakut për t'u testuar në HIV, HBV, HCV (vetëm PID) dhe sifilis. Vlerësimi i popullatës dhe intervali korrespondues i konfidencës 95% janë përshtatur nga madhësitë diferenciale të rrjeteve përmes vlerësuesit suksesiv të mostrimit¹ në softuerin e RDS analyst (www.hpmsg.org). Grafikonet e zingjirëve të rekrutimit janë krijuar përmes Netdraw në UCINET 6.0 (www.analytictech.com). Përveç kësaj, në këtë studim janë shfrytëzuar metodat e objektit unik dhe ato të shumëzimit të shërbimeve dhe metoda e madhësisë suksesive të mostrës

¹ Gile K, Handcock M. Respondent-Driven Sampling: An Assessment of Current Methodology (2010). arXiv:0904.1855v1. Sociological Methodology. 40: 285-327.

(SS size)² me MDR analizues për të gjeneruar vlerësimin e madhësisë së popullatave (VMP) për PID dhe MSM. Të gjeturat nga ky studim ofrojnë pikën bazë për monitorim dhe evaluim, identifikim të boshllëqeve në programet ekzistuese dhe ndihmojnë në zhvillimin e strategjive për intervenime afatgjate dhe prarandaluese sipas nevojave të PID dhe MSM në Kosovë.

² Handcock MS, Gile KJ, Mar CM. Estimating hidden population size using Respondent-Driven Sampling data. *Electron. J. Statist.* Volume 8, Number 1 (2014), 1491-1521.

PËRMBAJTJA

ASISTENCA TEKNIKE DHE PËRGATITJA E RAPORTIT	2
MIRËNJOHJE	3
SHKURTESAT/ AKRONIMET	6
PËRMBLEDHJE	7
PËRMBAJTJA	9
HISTORIKU	13
HIV NË KOSOVË	14
ARSYESHMËRIA DHE OBJEKTIVAT	15
OBJEKTIVAT SPECIFIKE	15
PËRMBUSHJA E KRITEREVE	16
METODAT	17
HULUMTIMI FORMATIV	17
VENDI I GRUMBULLIMIT TË TË DHËNAVE	17
MOSTRIMI I DREJTUAR NGA RESPONDENTI (MDR) PËR REKRUTIMIN E PID DHE MSM	18
<i>Procesi i rekrutimit me MDR</i>	19
LLOGARITJA E MADHËSISË SË MOSTRËS	21
ZHVILLIMI I MJETEVE TË PUNËS	21
STAFI	22
PROCEDURAT E LABORATORIT	23
GRUMBULLIMI, RUAJTJA, TRANSPORTI DHE PROCESIMI I MOSTRAVE BIOLOGJIKE	23
PROCEDURAT E REZULTATEVE	23
MENAXHIMI DHE ANALIZA E TË DHËNAVE	24
PREZENTIMI I TË DHËNAVE	25
VLERËSIMI I MADHËSISË SË POPULLATËS	26
METODAT E SHUMËZIMIT	26
<i>Shumëzimi i objektit unik</i>	26
<i>Shumëzimi i shërbimeve</i>	26
<i>Supozimet e shumëzimit</i>	27

<i>Llogaritja e shumëzimit.....</i>	<i>27</i>
<i>Intervalet e konfidencës për metodën e shumëzimit.....</i>	<i>28</i>
VLERËSIMET E MADHËSISË SUKSESIVE TË MOSTRIMIT (SS-SIZE) _____	28
MENÇURIA E TURMËS _____	29
ÇËSHTJET ETIKE _____	30
KUFIZIMET _____	31
SHFRYTËZIMI I TË DHËNAVE PËR KRIJIM TË NJOHURIVE _____	32
PËRMBLEDHJE _____	33
KARAKTERISTIKAT SOCIO-DEMOGRAFIKE _____	34
MOBILITETI NË 12 MUAJT E FUNDIT _____	35
SJELLIET E PËRGJITHSHME SEKSUALE _____	36
PARTNERËT SEKSUAL MESHKUJ TË QËNDRUESHËM _____	36
PARTNERËT SEKSUAL TË RASTËSISHËM _____	37
PARTNERËT E PAGUAR SEKSUAL (PJESËMARRËSI KA PAGUAR PËR SEKS) _____	39
PARTNERËT SEKSUAL MESHKUJ ME PAGESË (PJESËMARRËSI KA MARRË TË HOLLA PËR SEKS) _____	40
PARNERËT SEKSUAL MESHKUJ TË HUAJ _____	41
TAKIMI I PARTNERËVE SEKSUAL MESHKUJ _____	41
SEKSI ME FEMRA _____	42
PËRDORIMI I KONDOMIT DHE LUBRIFIKANTËVE NË PËRGJITHËSI _____	42
PËRDORIMI I ALKOOLIT, DROGËS DHE PRAKTIKAT E INJEKTIMIT NË 12 MUAJT E FUNDIT _____	44
STIGMA, DISKRIMINIMI DHE DHUNA _____	46
SHENJAT DHE SIMPTOMET E IST NË 12 MUAJT E FUNDIT _____	47
NJOHURITË PËR HIV _____	48
TESTIMI NË HIV _____	50
KONDOMI DHE PROGRAMET E PARANDALIMIT _____	51
VLERËSIMET E MADHËSISË SË POPULLATËS PËR MSM _____	53
OBJEKTI UNIK _____	53
<i>MSM Prishtinë.....</i>	<i>53</i>

SHUMËZIMI I SHËRBIMIT PËR SHPËRNDARJE TË KONDOMAVE _____	54
MADHËSIA E MOSTRËS SUKSESIVE (SS-SIZE) _____	55
MENÇURIA E GRUPIT _____	55
VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR I MADHËSISË SË POPULLATËS _____	55
DISKUTIMI DHE REKOMANDIMET _____	57
SJELLJET SEKSUALE ME RREZIK TË LARTË _____	57
QASJA NË KONDOMA DHE SHËRBIMET E PEER EDUKIMIT _____	57
SEKSI I PAMBROJTUR ME FEMRA _____	58
PËRDORIMI I ULËT I ALKOOLIT DHE MESATAR I DROGËS JO INJEKTUESE _____	58
NJOHURITË KONTRADIKTORE TË BARTJES SË HIV _____	58
TESTIMI MESATAR NË HIV _____	59
DIAGNOSTIKIM I ULËT I IST DHE INFEKSIONIT NË SIFILIS _____	59
NIVEL I ULËT DHE MESATAR I ABUZIMIT FIZIK DHE NIVEL I LARTË I FSHEHJES _____	59
PREVALENCA E ULËT E HIV _____	60
VLERËSIMET E MADHËSISË SË POPULLATËS _____	60
TË GJETURAT E STUDIMIT NË MESIN E PERSONAVE QË INJEKTOJNË DROGË _____	61
PËRMBLEDHJE _____	61
KARAKTERISTIKAT SOCIO-DEMOGRAFIKE _____	63
PËRDORIMI I DROGËS NË PËRGJITHËSI _____	64
PRAKTIKAT E INJEKTIMIT _____	65
SHKËMBIMI I GJILPËRAVE DHE SHIRINGAVE NË MUAJIN E FUNDIT _____	66
PËRDORIMI I GJILPËRAVE DHE SHIRINGAVE STERILE PËR INJEKTIM TË DROGËS _____	67
PASTRIMI DHE DEZINFETIMI I GJILPËRAVE DHE SHIRINGAVE _____	68
SJELLJET E PËRGJITHSHME SEKSUALE _____	68
SEKSI KOMERCIAL _____	70
NJOHURITË PËR BARTJEN E HIV DHE PERCEPTIMET _____	71
TESTIMI NË IST _____	72
TESTIMI NË HIV _____	73

MBIDOZA DHE MARRJA E SHËRBIMEVE TË PID _____	74
ARRESTIMET DHE BURGOSJET _____	75
PREVALENCA E HIV, HBV, HCV DHE SIFILISIT _____	75
VLERËSIMET E MADHËSISË SË POPULLATË PËR PID _____	77
OBJEKTI UNIK _____	77
SHUMËZIMI I SHËRBIMIT PËR TESTIM NË HIV _____	77
SS MADHËSIA _____	78
MENÇURIA E GRUPIT _____	79
VLERËSIMI FINAL I MADHËSIVE TË POPULLATËS _____	79
DISKUTIMI DHE REKOMANDIMET _____	81
PREVALENCA ME ASNJË HIV, E ULËT NË SIFILIS DHE HBV DHE MESATARE NË HCV _____	81
KONSUMIMI I LARTË I LLOJEVE TË NDRYSHME TË DROGAVE _____	81
SHKËMBIMI I ULËT I GJILPËRAVE DHE SHIRINGAVE _____	81
MË SHUMË PID NË PRISHTINË SE SA NË PRIZREN SHKËMBEJNË PAISJE TË INJEKTIMIT _____	82
PAK FEMRA JANË PËRFSHIRË NË KËTË STUDIM _____	82
NJOHURI TË ULËTA SE SI TË DEZINFEKTOJNË SHIRINGAT DHE GJILPËRAT _____	82
PRAKTIKAT SEKSUALE ME RREZIK TË LARTË; VETËM GJYSMA E PID AKTUALISHT BËJNË SEKS _____	83
NJOHURI TË ULËTA PËR BARTJEN E HIV _____	83
TESTIMI NË HIV ËSHTË I ULËT _____	84
MË SHUMË PID NË PRISHTINË KANË MARRË TRAJTIM PËR TË ZVOGËLUAR OSE NDËPRERË DROGËN SE SA NË PRIZREN _____	84
PREVALENCË E LARTË E BURGOSJES NË PRISHTINË _____	85
MADHËSITË E POPULLATËS SË PID _____	85
PËRFUNDIMI _____	86
REFERENCAT _____	87
SHTOJCAT _____	89
PYETËSORI PËR PID _____	89

HISTORIKU

Ky raport paraqet të gjeturat nga studimi i tretë me radhë i integruar i sjelljes dhe biologjike në mesin e personave që injektojnë drogë (PID) në Prishtinë dhe Prizren dhe meshkujve që bëjnë seks me meshkuj (MSM) në Prishtinë të kryer gjatë muajit korrik, gusht dhe shtator të vitit 2014. Objektiva kryesore e studimeve ka qenë të ofroj informata për prevalencën e infeksionit me HIV dhe infeksioneve tjera seksualisht transmise (IST) si dhe faktorëve të rrezikut për t'iu ofruar k[to të dhëna programeve dhe politikave për reagim dhe të përcaktojë periudhën kohore për monitorimin e trendit të epidemisë.

MISB i parë është kryer në periudhën në mes të muajit shkurt dhe korrik të vitit 2006 me përkrahje financiare nga Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim (USAID) dhe programi i UNAIDS i menaxhuar nga UN Theme Group (UNTG) për HIV/AIDS në Kosovë. Këto studime janë kryer përmes mostrimit të drejtuar nga respondentit (MDR) në mesin e 200 PID në Prishtinë (n=129) dhe Prizren (n=71)³ dhe 69 MSM në Prishtinë.

SISB i dytë është kryer në vitin 2011 me përkrahje financiare të Fondit Global për luftimin e AIDS, Tuberkulozit dhe Malaries (FGATM). Studimet janë kryer në mesin e 205 PID dhe 204 MSM në Prishtinë përmes MDR.

³Të dhënat nga Prishtina dhe Prizreni janë të grupuara dhe kanë cenuar supozimin thelbësor të MDR. Këto të dhëna duhet të interpretohen me kujdes.

HIV në Kosovë

Kosova vlerësohet si vend me prevalencë nën 0.1%, me vetëm 90 raste të HIV të raportuara deri në dhjetor të vitit 2013. Edhe pse pritet që të ketë HIV më shumë tek popullatat me rrezik të lartë për HIV siç janë PID dhe MSM, asnjë infeksion me HIV nuk është gjet në asnjërën nga këto grupe në dy raundet e mëhershme të SISB të kryera në vitin 2006 dhe 2011 (Tabela 1). Asnjë rast me sifilis nuk është gjet në vitin 2006 dhe prevalencë e ulët në vitin 2011. Është gjet prevalencë e lartë e hepatitit B (HBV) tek të dyja grupet në studimet e vitit 2006, mirëpo në vitin 2011 ka qenë shkalla shumë më e ulët. Prevalenca e hepatitit C (HCV) në mesin e PID është trefishuar nga viti 2006 në vitin 2011 dhe në mesin e MSM ka pas një rritje të lehtë nga 0 në 1.0 nga viti 2006 në vitin 2011.

Tabela 1. Prevalenca e HIV, Sifilisit, Hepatitit B (HBV) dhe Hepatitit C (HCV) në mesin e PID dhe MSM, 2006 dhe 2011.

Test	2006		2011	
	PID [^]	MSM	PID	MSM
HIV	0	0	0	0
Sifilis	0	0	2 (0.3, 4.3)	2.4 (0.4, 5.1)
HBV	20.1 (12.2, 29.5)	14.9 (3.8, 28.3)	6 (3.0, 10.5)	2.2 (0.6, 4.5)
HCV	12.5 (8.0 17.7)	0	37.4 (28.9, 46.8)	0.1 (0, 0.4)

[^]Këto të dhëna janë të grupuara, kështu që mund të mos jenë reprezentative për popullatën e mostruar

ARSYESHMËRIA DHE OBJEKTIVAT

Në verën e vitit 2014 është kryer studimi i MISB në mesin e personave që injektojnë drogë (PID) në Prishtinë dhe Prizren, si dhe në mesin e meshkujve që bëjnë seks me meshkuj (MSM) në Prishtinë.

Objektivat specifike

Objektiva specifike e studimit ka qenë përcaktimi i prevalencës së HIV dhe IST të lidhura me sjelljet e rrezikshme dhe të ofrojnë pikën bazë për monitorimin e trendit të epidemisë së HIV në popullatat kyçe në rrezik të përzgjedhura dhe në qytetet e zgjedhura të Kosovës. Përveç kësaj, objektivat tjera të studimit kanë qenë:

- Matja e karakteristikave kryesore socio-demografike.
- Kuantifikimi i përdorimit të alkoolit dhe drogës.
- Vlerësimi i shfrytëzimit dhe qasjes në programe shëndetësore dhe të mirëqenies sociale.
- Vlerësimi i njohurive dhe qëndrimeve ndaj HIV/AIDS.
- Evaluimi i stigmës dhe diskriminimit ndaj personave që jetojnë me HIV.
- Matja e shfaqjes së IST-ve dhe kërkimi i trajtimit të duhur.
- Evaluimi i njohurive dhe qasja në shërbimet parandaluese.
- Fuqizimi i kapaciteteve hulumtuese në vend.
- Hartimi i rekomandimeve për programe dhe zgjerimi i shërbimeve si dhe identifikimi i mjeteve për ngritjen e mbulueshmërisë dhe përfshirjes me programe të PID dhe MSM në Kosovë.
- Vlerësimi i madhësisë së popullatave të PID në Prishtinë dhe Prizren dhe MSM në Prishtinë.

Përmbushja e kriterëve

Pjesëmarrësit që kanë përmbush kriteret kanë qenë të moshës mbi 18 vjeç dhe është kërkuar që ata të jetojnë dhe/ose punojnë në vendin ku është kryer studimi. Përveç kësaj: nga PID është kërkuar që ata të kenë injektuar drogë në muajin e fundit dhe për MSM është kërkuar që të kenë pas seks anal me mashkull gjatë vitit të fundit.

METODAT

Hulumtimi formativ

Intervistat me personat që kanë informata janë kryer gjatë javës së 26 majit, 2014 me qëllim të identifikimit të çështjeve potenciale të mostrimit lidhur me MDR (p.sh. madhësitë e rrjetit social, karakteristikat e rrjetit, pranueshmëria e MDR, etj.), zgjidhja e çështjeve logjistike të studimit (p.sh. shuma e pagesës/stimulimit, lokacioni i preferuar për qendër të intervistimit, orari i punës, testimi në HIV dhe rezultatet, etj.) dhe përcaktimi i teknikave adekuate për vlerësim të madhësisë së popullatës. Poashtu janë mbledhur edhe informatat që na kanë ndihmuar në përpilimin e pyetësorëve për sjellje. Të gjeturat nga aktivitetet e hulumtimit formativ janë inkorporuar në dizajnimin e studimit dhe hartimin e pyetësorëve final të sjelljeve.

Të gjeturat kryesore nga hulumtimi formativ kanë treguar se PID mund të mostrohen më lehtë në Prishtinë dhe Prizren, ndërsa MSM në Prishtinë përmes MDR. Madhësia e popullatave mund të vlerësohet përmes objekteve unike dhe shumëzimit të shërbimeve, metodës së mostrimit suksesiv (SS-size) dhe numërimit të 'mençurisë së grupit'.

Vendi i grumbullimit të të dhënave

PID janë mostruar përmes organizatës joqeveritare (OJQ) vendore, Labirinti me bazë në Prishtinë dhe Prizren. Që nga viti 2002 Labirinti ofron trajtim për droga dhe zvogëlim të dëmit personave që përdorin drogë. MSM janë mostruar përmes Qendrës për Zhvillim të Grupeve Shoqërore (CSGD), OJQ e cila ofron shërbime të testimit për HIV dhe shërbime për popullatën MSM në Prishtinë që nga viti 2002. Labrinti dhe CSGD kanë qenë të përfshira në SISB tek PID dhe MSM në vitin 2011. Prishtina është kryeqyteti dhe qyteti më i madh, poashtu edhe qendra më e madhe administrative, arsimore dhe kulturore e Kosovës (popullata 205,133 banorë të regjistruar)⁴ (Figura 1). Prizreni gjendet në pjesën juglindore të Kosovës dhe është qyteti i dytë më i madh në Kosovë (popullata afërsisht 178,000)⁵.

⁴ Agjencioni i Statistikave të Kosovës (shqip). 31 dhjetor 2012. Qasur më 1 tetor 2014.

⁵ Regjistrimi i popullsisë dhe amvisërive 2011. Qasur në <http://www.osce.org/kosovo/13128?download=true> më 1 tetor 2014.

Figura 1. Harta e Kosovës ku identifikohen Prishtina dhe Prizreni.



Mostrimi i drejtuar nga responenti (MDR) për rekrutimin e PID dhe MSM

Në këtë studim është shfrytëzuar MDR për rekrutimin e PID në Prishtinë dhe Prizren, si dhe MSM në Prishtinë. MDR është verzion i metodës së mostrimit përmes zingjirit të referimit, e cila kur implementohet dhe analizohet në mënyrë të duhur, prodhon të dhëna reprezentative për popullatën nga e cila është marrë mostra^{6,7}. Rekrutimi fillon me një numër të zgjedhur të pjesëtarëve të popullatës për studim të cilëve iu referohemi si “farë”. Pas regjistrimit dhe përfundimit të të gjitha fazave të studimit, secilës farë i jepet numër i caktuar (jo më shumë se tre) i kuponëve me numër unik me të cilët ata rekrutojnë shokët/kolegët e tyre (PID dhe MSM tjerë që i përmbushin kriteret) në studim. Këta të rekrutuar të cilët regjistrohen dhe përfundojnë të gjitha fazat e studimit konsiderohen si vala e parë e responentëve. Secili responent në valën e parë i cili regjistrohet dhe përfundon

⁶Heckathorn DD. (1997) Respondent-driven sampling: A new approach to the study of hidden populations. *Sociological Problems*. 44 (2), 174-199.

⁷Heckathorn, DD. (2002). Respondent driven sampling II: deriving valid population estimates from Chain-Referral samples of hidden populations. *Sociological Problems*,49(1), 11-34.

të gjitha fazat e studimit i jepet numër i caktuar i kuponëve përmes të cilëve ata rekrutojnë të tjerët për studim. Valët e njëpasnjëshme të rekrutimit, në mënyrë ideale rezultojnë me zingjirë të gjatë të rekrutimit të respondentëve dhe vazhdojnë deri sa të arrihet madhësia e mostrës.

Secili respondent pyetet për madhësinë e rrjetit social të tij ose saj gjë e cila ka lidhje të drejtëpërdrejtë me përmbushjen e kriterëve dhe krijon mundësinë e përzgjedhjes së secilit rekrut në mostër. Madhësitë e rrjeteve sociale të cilat ata vetë i raportojnë merren parasysh si kornizë e mostrës e cila shfrytëzohet për krijimin e peshimit për nxjerrjen e vlerësimeve. Peshimet aplikohen anasjelltas ku ata me rrjet social më të madh (aftësia për të rekrutuar më shumë pjesëmarrës dhe normal i mbireprezentuar në metodën standarde të mostrimit top dëbore) kanë peshim relativisht më të ulët dhe ata me rrjet social më të vogël kanë peshim relativisht më të lartë. Për më tepër, të dhënat analizohen me modele matematikore të procesit të rekrutimit (lidhjet e rrjetit social rekrutues-i rekrutuar) për të gjeneruar probabilitetin relativ të përfshirjes dhe të mat nivelin e përpjekjeve për rekrutim dhe homofilinë (rekrutimi jo i randomizuar i personave me karakteristika të ngjajshme me rekrutin). Procesi i rekrutimit se kush kë e ka rekrutuar monitorohet përmes numrave unik të kuponëve të rekrutimit të secilit pjesëmarrës. Numrat unik të kuponëve sigurojnë poashtu anonimitetin e respondentëve duke e lidhur secilin respondent me pyetësoin e tyre dhe rezultatet e testeve biologjike, duke shmangur marrjen e emrave, adresave ose të dhënave të tjera personale.

Kur përmbushen të gjitha kërkesat metodologjike dhe teorike, MDR jep vlerësimet e parametrave të popullatës mbi të cilat mund të arrihen konkluzione në lidhje me karakteristikat dhe sjelljet e popullatës së mostruar.

Procesi i rekrutimit me MDR

Fillimisht, janë zgjedhur tri farat për secilën mostër të popullatës. Megjithatë, bazuar në progresin e rekrutimit dhe se disa farë nuk kanë rekrutuar të tjerë apo zingjirët e rekrutimit janë ndërprerë, janë shtuar disa farë tjera për të gjitha popullatat. Farët për PID dhe MSM janë identifikuar përmes stafit të Labirintit dhe CSGD.

Farëve të identifikuar për studim të popullatës iu janë dhënë secilit nga tre kuponë me kod unik të cilët i kanë përdor për rekrutimin e shokëve/kolegëve të tyre për studim. Respodentët të cilët i kanë paraqit kuponët valid të rekrutimit në qendrën e studimit janë skrinuar se a i përmbushin kriteret dhe e kanë dhënë pëlqimin për intervistim ballë për ballë, këshillimin para testimit për HIV dhe marrjen e gjakut për testim në HIV, sifilis, HBV dhe HCV. Intervistat janë kryer në gjuhën shqipe nga intervistuesit e trajnuar dhe kanë zgjatë afërsisht 35 minuta deri në përfundim. Pas intervistimit, secilit respodent i është dhënë numër i caktuar i kuponëve (jo më shumë se tre) për të rekrutuar të tjerët që i përmbushin kriteret.

Respodentët kanë marrë kompenzimin e parë në shumë prej 10 Euro për shpenzime të transportit dhe kompenzimin e dytë në shumë prej 5 Euro për secilin të rekrutuar (maksimum tre) i cili i ka përmbush kriteret dhe ka dhënë pëlqimin të marrë pjesë dhe të përfundoj të gjitha fazat e studimit. Përfundimi i të gjitha fazave të studimit ka përfshirë pyetëtorin për sjellje dhe testimin biologjik. Gjatë procesit të dhënies së pëlqimit atyre iu është shpjeguar se ata nuk mund ta marrin kompenzimin e as kuponët për rekrutim nëse ata vendosin të mos japin mostrën biologjike. Nuk është marrë asnjë informatë që bën identifikimin personal. Për të siguruar konfidencialitetin, pyetëtorët e respodentëve dhe testet biologjike janë identifikuar përmes numrit unik identifikues të studimit që iu është dhënë në kuponët e rekrutimit.

Llogaritja e madhësisë së mostrës

Në studimin e vitit 2006 për PID madhësia e mostrës ka qenë N=71 në Prizren dhe N=129 në Prishtinë dhe në studimin e vitit 2011 për PID madhësia e mostrës ka qenë N=205 në Prishtinë (në vitin 2011 nuk është kryer studimi në Prizren). Në studimin e vitit 2014 mostra është rritur për PID në N=300 në Prishtinë dhe N=200 në Prizren. Në Prishtinë, në studimin e vitit 2006 për MSM ka qenë N=69 dhe N=204 në vitin 2011. Në studimin e vitit 2014 mostra për MSM është rrit në N=300 në Prishtinë.

Tabela 2. Mostrat finale për SISB 2014

Popullata	Qyteti	Mostra
PID	Prishtinë	300
PID	Prizren	200
MSM	Prishtinë	300

Zhvillimi i mjeteve të punës

Protokollët dhe pyetësorët përfundimtar të SISB janë finalizuar nga ekipi i IKSHP, grupi referent i studimit dhe OJQ Labirinti për PID dhe CSGD për MSM.⁸ Përmes pyetësorit janë grumbulluar të dhënat e karakteristikave socio-demografike, sjelljet e rrezikshme dhe droga, bartja e HIV, shenjat dhe simptomet për HIV dhe IST, njohuritë për HIV, perceptimet, stigma dhe diskriminimi, informatat për madhësinë e rrjetit social të respondentëve si dhe qasja dhe shfrytëzimi i shërbimeve për HIV. Protokollit dhe pyetësorit janë dorëzuar për shqyrtim etik dhe aprovim nga Bordi Etik i Ministrisë së Shëndetësisë, Republikës së Kosovës.

⁸Family Health International. (2000). Behavioral Surveillance Surveys: Guidelines for Repeated Behavioral Surveys in Populations at Risk of HIV. Arlington, VA: Family Health International. Available at: <http://www.fhi.org/en/HIVAIDS/pub/guide/bssguidelines.htm>.

Stafi

Anëtarët e stafit për studim janë rekrutuar përmes organizatave joqeveritare Labirinti (për PID) dhe CSGD (për MSM). Anëtarët e stafit të PID dhe MSM janë trajnuar tre ditë për rolin dhe përgjegjësitë e stafit, procesin e dhënies së pëlqimit etik, përcjelljen e kuponëve dhe responentëve, procesin e kompenzimit, administrimin e pyetësorit, marrjen e mostrave biologjike, procesimin dhe transportin e mostrave biologjike dhe dhënia e rezultateve të testeve biologjike dhe referimin.

PROCEDURAT E LABORATORIT

Grumbullimi, ruajtja, transporti dhe procesimi i mostrave biologjike

Pas intervistës dhe këshillimit para testimit, tekniku i laboratorit ka marrë mostrën e gjakut venoz përafërsisht pesë mililitra në vakutaner. Mostrat biologjike janë ruajtur në frigorifer në zyre ku është kryer studimi deri sa janë transportuar në laboratorin e Departamentit të Mikrobiologjisë të IKSHP në Prishtinë, Kosovë. Në laborator, mostrat janë centrifuguar dhe serumi është ruajtur në temperaturë minus 20°C derisa është kryer testimi. Testimi ka qenë anonim dhe i lidhur. Mostrat janë testuar me testet ELISA për prezencën e antitropave kundër HIV1/2, IgM dhe IgG antitropave kundër *Treponema pallidum* dhe prezencën e HBsAg dhe antitropave kundër HBsAg (antiHBs) dhe antitropat kundër HCV (vetëm tek PID). Mostrat të cilat kanë qenë fillimisht pozitive në ELISA anti-HIV1/2 janë testuar me testin konfirmues Western Blot HIV1/2 dhe ngjajshëm, mostrat të cilat kanë qenë fillimisht pozitive për anti-HCV janë testuar me Line Immunoassay testin konfirmues për prezencën e antitropave kundër HCV.

Procedurat e rezultateve

Testet janë procesuar në laboratorin kombëtar në Prishtinë një herë ose dy herë në javë në mënyrë që rezultatet t'iu jepen sa më parë. Rezultatet e testeve janë regjistruar në formularë dhe janë mbyllur në kovertë dhe iu janë dërguar koordinatorëve respektivë në secilën qendër.

MENAXHIMI DHE ANALIZA E TË DHËNAVE

Të dhënat janë fut në dy baza të të dhënave në Microsoft Excel: njëra për të monitoruar progresin e rekrutimit, përcjelljen e numrave të kuponëve dhe tjetra për ruajtjen e të dhënave të sjelljeve të studimit. Pastrimi i të dhënave dhe kontrolla e kualitetit janë kryer nga IKSHP në Prishtinë. Bazat e të dhënave finale janë bashkuar dhe janë kontrolluar për konsistencën e tyre. Frekuencat dhe grupimi në tabela është bërë për të kontrolluar validitetin dhe logjikën e të gjitha variablave në bazën e të dhënave. Pyetësorët e plotësuar janë ruajtur në IKSHP në Prishtinë. Të dhënat janë formatizuar dhe koduar në Microsoft Excel dhe SPSS para se të transerohen në RDS Analyst (www.hpmsg.org). Vlerësimet e popullatës dhe intervalet e konfidencës 95% janë llogarit përmes vlerësuesit suksesiv të mostrave⁹. Grafikonët e rekrutimit për mostrat e MDR janë krijuar përmes NETDRAW në UCINET (<http://www.analytictech.com/ucinet/download.htm>).

⁹Gile K, Handcock M. Respondent-Driven Sampling: An Assessment of Current Methodology (2010). arXiv:0904.1855v1. Sociological Methodology. 40: 285-327.

PREZENTIMI I TË DHËNAVE

Të dhënat për secilën popullatë janë prezentuar në tabela në seksione të veçanta. Për të dhënat kategorike, kategoria madhësia (n), vlerësimet e rregulluara dhe intervali i konfidencës 95% dhe për të dhënat e vazhdueshme janë prezentuar mesatarja dhe vlerat minimale dhe maksimale.

VLERËSIMI I MADHËSISË SË POPULLATËS

Madhësitë e popullatave të PID dhe MSM në secilin qytet ku është kryer studimi janë vlerësuar përmes katër metodave: 1) shumëzimi i objektit unik¹⁰; 2) metoda e shumëzimit të shërbimeve¹¹; 3) madhësia e mostrës suksesive (SS-size)¹²; dhe 4) numërimi me ‘mençurinë e grupit’

Metodat e shumëzimit

Të dyja metodat e shumëzimit bëhen me mbivendosjen e numërimit të pavarur të popullatës për ta ekstrapoluar në madhësinë e përgjithshme të popullatës.

Shumëzimi i objektit unik

Më metodën e shumëzimit të objektit unik kuptojmë shpërndarjen e objekteve unike tek pjesëtarët e popullatës në secilin qytet një javë para fillimit të studimit MDR. Numërohet numri i objekteve të shpërndara (shumëzuesi) dhe përdoret për llogaritjen në raport me ata të cilët raportojnë që e kanë marrë objektin (i shumëzueshmi) në mënyrë që të nxjerrim vlerësimin e popullatës.

Shumëzimi i shërbimeve

Me shumëzim të shërbimeve kuptojmë të dhënat e shërbimeve ku bëhet numërimi unik i pjesëtarëve të popullatës të cilët kanë marrë një shërbim në secilin qytet gjashtë muaj para fillimit të studimit MDR. Shumëzuesi i dytë është numëruar gjatë studimit MDR duke pyetur secilin respondent se a kanë marrë ndonjë shërbim të paktën një herë në të njëjtën periudhë gjashtë mujore.

¹⁰UNAIDS. Guidelines on Estimating the Size of Populations Most at Risk to HIV. Accessed on August 15, 2012 at: whqlibdoc.who.int/publications/2010/9789241599580_eng.pdf.

¹¹IBID.

¹²Handcock M, Gile K, Mar C. 2012. Estimating Hidden Population Size using Respondent-Driven Sampling Data. Unpublished article.

Supozimet e shumëzimit

Supozimet për shumëzim janë:

- Dy burime të të dhënave të mbivendosura (specifike për grupin që është numëruar)
- Popullata e numëruar duhet të ketë probabilitet jo-zero të përfshirjes në të dyja burimet
- Një burim i të dhënave (p.sh. studimi) duhet të jetë i randomizuar dhe të përfshijë grupin në shumëzim, por mund të përfshijë edhe të tjerët.
- Burimi i dytë i të dhënave (shumëzuesi) nuk duhet të jetë i randomizuar duhet të jetë specifik për grupin i cili vlerësohet
- Asnjë individ nuk numërohet më shumë se një herë gjatë shumëzimit
- Dy burime të të dhënave duhet të jenë të pavaruara nga njëra tjetra (përfshirja në njërin nuk është e lidhur me përfshirjen në tjetrën)
- E kufizuar në migrimet brenda dhe jashtë

Llogaritja e shumëzimit

Numri i pjesëtarëve të popullatës të cilët kanë marrë objektin unik një javë para fillimit të studimit paraqet numeratorin (M) dhe raporti i atyre të cilët kanë raportuar se e kanë marrë objektin një javë para fillimit të studimit paraqet denominatorin (P). Formula matematikore për llogaritjen e madhësisë së popullatës:

$$N = M/P$$

Ku:

N=Madhësia e vlerësuar

P=Raporti i pjesëtarëve të popullatës në studim të cilët kanë raportuar se kanë e kanë marrë objektin/shërbimin.

M=Numri pjesëtarëve të popullatës të cilëve iu është shpërndarë objekti ose iu është ofruar shërbimi.

Intervalet e konfidencës për metodën e shumëzimit

Formula e mëposhtme është përdor për llogaritjen e kufijve të konfidencës 95% për vlerësimin e popullatës:

$$Var(N) = \frac{Var(M)}{[E(P)]^2} + \frac{[E(M)]^2}{[E(P)]^4} Var(P)$$

$$CI_{95\%} \text{ for } N = N \pm 1.96 \times \sqrt{Var(N)}$$

Ku:

N=Vlerësimet e madhësisë së popullatës

M=Numri i pjesëtarëve të popullatës të cilët kanë marrë objektin/shërbimin.

E(P)= Raporti i pjesëtarëve të popullatës në studim të cilët kanë raportuar se e kanë marrë objektin/shërbimin.

E(M)=Numri i pritur i pjesëtarëve të popullatës të cilët mund të kenë marrë objektin/shërbimin.

Var(M)=Si M, numri i atyre që e kanë marrë objektin/shërbimin, Var(M) është e barabartë me M.

Var(P)=Variance e mbivendosjes së pjesëtarëve të popullatës të cilët kanë marrë objektin/shërbimin (SE²) e nxjerrë nga rezultatet e RDS Analyst.

Supozimet për llogaritjen e kufijve të konfidencës janë:

- N dhe P janë dy variabla të pavarura (kovarianca = 0)
- P ka përafërsisht shpërndarje normale me Gabim Standard barabartë me SE. Rezultatet e RDS Analyst për SE dhe P dalin nga metoda e percentiles së nxjerrë¹³ dhe mund të jetë asimetrik.
- P ka koeficient të vogël të variacionit.

Vlerësimet e madhësisë suksesive të mostrimit (SS-size)

Metoda e vlerësimit të madhësisë së popullatës SS, i shfrytëzon të dhënat e grumbulluara gjatë MDR studimit për madhësinë e rrjetit social të pjesëmarrësit për të kuantifikuar madhësinë e popullatës duke supozuar që shpërndarja e madhësisë së rrjetit të valëve të

¹³Ibid.

njëpasnjëshme reflekton shpërndarjen e popullatës. Vlerësimet bëhen përmes kornizës së Bayes-it (p.sh. kuantifikon paqartësinë për kuantitetet e panjohura duke i lidhur ato me kuantitete të njohura) ku inkorporohen informatat për “supozimin” ose njohuritë e mëparshme të madhësisë së popullatës së mostruar. Korniza e Bayes-it poashtu lejon edhe llogaritjen e intervaleve të probabilitetit.

Mençuria e turmës

Kjo metodë shfrytëzon numërimin e bazuar në vlerësimet e pjesëmarrësve në studim. Secili pjesëmarrës është pyetur për numrin më të lartë, të ulët dhe më të saktë të pjesëtarëve të popullatës në qendrat respektive të studimit. Mesatarja e këtyre përgjigjeve është llogaritur për të dhënë vlerësim për madhësinë e popullatës.

ÇËSHTJET ETIKE

Pjesëmarrja në studim ka qenë vullnetare dhe respondentët janë informuar që ata janë të lirë të tërhiqen nga studimi në çdo kohë gjatë procesit të studimit. Duke iu përcjellë me kujdes shpjegimet për studim, stafi iu ka dhënë respondentëve që i kanë përmbush kriteret, formularin e pëlqimit për ta lexuar, nësa ka pas nevojë formulari i pëlqimit iu është lexuar nga vetë stafi. Të gjithë respondentët ose e kanë nënshkruar ose e kanë dhënë pëlqimin verbal q[ata i kanë kuptuar dhe pajtohen për të gjitha çështjet që përmban formulari i pëlqimit para se të përfshihen në studim. Për t'u përfshirë në studim, pjesëmarrësit potencial është dashur të pajtohen që të përfundojnë intervistën për sjellje si dhe testimin biologjik. Për të minimizuar jo rehatin[për shkak të natyrës senzitive të pyetjeve që janë parashtruar, pyetësi është administruar në hapësirë private dhe konfidenciale. Respondentët kanë mund të refuzojnë të përgjigjen në secilën pyetje. Të gjithë respondentëve iu është dhënë emri dhe numri i telefonit të koordinatorit të qendrës, nëse ata kanë pas ndonjë pyetje për studimin ose nëse ata kanë besuar se janë lënduar ose keqtrajtuar si rezultat i përfshirjes së tyre në studim.

Të gjitha të dhënat e studimit, përfshirë informatat biologjike dhe të sjelljeve, kanë qenë konfidenciale. Ekipi i studimit nuk i ka regjistruar emrat, adresat ose të dhënat tjera personale në pyetësor ose në mostrat dhe rezultatet laboratorike. Numrat identifikues të kuponëve kanë qenë të caktuar për secilin respondent dhe i kanë lidh përgjigjet në pyetësor me formularët dhe rezultatet e testeve laboratorike dhe janë ruajtur në vend të sigurtë në zyrat ku është kryer intervistimi para se të transferohen në IKSHP në Prishtinë.

KUFIZIMET

Gjatë studimit ka pas disa kufizime. Për shkak se të dhënat e sjelljeve janë vetë-raportuar gjatë intervisitimit ballë për ballë dhe në ndërtesat e OJQ-ve, biasi social mund të ketë rezultuar me nënraportim të sjelljeve të rrezikshme. Pasi që studimi është mbajtur në një OJQ që ka qenë e njohur për respondentët që aty ofrohen shërbime për HIV dhe shërbime të tjera, ka mund të jetë më prevalent se sa sikur studimi të ishte mbajtur në një vend tjetër.

Kompenzimi për respondentët është elementi kryesor i rekrutimit në MDR, mirëpo mund të jetë sfidues në përcaktimin e shumës së përshtatshme për secilën popullatë në vendin e dhënë. Nëse kompenzimi i ofruar është shumë i lartë, ekziston rreziku që rekrutët mund t'i përmbushin kriteret në mënyrë të rrejshme. Nëse shuma është shumë e ulët, rekrutimi nuk do të jetë i suksesshëm. Për studime të tilla, shuma e kompenzimit është caktuar në bazë të takimeve me ekspertë gjatë hulumtimit formativ para studimit. Për të parandaluar përfshirjen e dyfishtë të respondentëve dhe për të siguruar se të gjithë i kanë përmbush kriteret, të gjithë të rekrutuarit në qendrat e studimit janë skrinuar nga skrinuesit e trajnuar dhe me përvojë punë me popullatat e caktuara. Çdonjëri që ka tentuar të hyj në studim dhe është gjet se ka marrë pjesë më parë ose nuk i ka përmbush kriteret, i është marrë kuponi dhe është hudhur nga stafi dhe iu është kërkuar që të dalin nga qendra.

Edhe pse vlerësimet për PID dhe MSM të prezentuara këtu mund të merren reprezentative për rrjetin e popullatës nga të cilat janë rekrutuar respondentët, numër i vogël i vlerave të variablave të caktuara mund të kufizojë mundësinë e nxjerrjes së vlerësimeve të sakta. Në disa raste, intervalet e konfidencës janë shumë të gjëra për interpretim të kuptimtë. Më tutje, pasi që MDR analisti varet nga integriteti i zingjirëve për të përcaktuar dhe rregulluar mundësinë e rekrutimit, vlerat që mungojnë mund të ndërrojnë vlerësimet e propocioneve të rregulluara.

SHFRYTËZIMI I TË DHËNAVE PËR KRIJIM TË NJOHURIVE


MDR mbështetet në njohjen e strukturës themelore të rrjetit social i cili mostrohet dhe premisave teorike të cilat jo gjithmonë mund të arrihen. Kështu që është me rëndësi të mbështetemi në këto të gjetura si vlerësime, se sa si fakte dhe të merren intervalet e konfidencës si udhërrëfyes se si mund të jenë vlerësimet e vlerave të sipërme dhe të poshtme në qoftë se këto studime do të përsëriteshin disa herë tek popullata e njëjtë. Për disa variabla, intervalet e konfidencës janë shumë të gjërë. Këto vlerësime me intervale të gjëra të konfidencës duhet të interpretohen me kujdes. Të dhënat nga SISB që shfrytëzojnë cilëndo metodë të mostrimit duhet të triangulohen me të dhënat tjera relevante nga mbikëqyrja sentinel, qendrat për KTV, OJQ-të të cilat punojnë me popullatat me rrezik të lartë, mapingu si dhe hulumtimet tjera kualitative për të krijuar të kuptuarit më optimal se si HIV afekton këto popullata. Përveç kësaj, bashkë me të dhënat tjera të modelohet trendi i epidemisë në vend.

TË GJETURAT E STUDIMIT TEK MESHKUJT QË BËJNË SEKS ME MESHKUJ

Përmbledhje

Gjatë një periudhe gati tre mujore, që nga fillimi i korrikut 2014, 217 MSM (përfshirë pesë farë) janë rekrutuar në Prishtinë. Numri maksimal i valëve të arritura në zingjirët e rekrutimit ka qenë 14 (shih grafikonin e rekrutimit, figura 2). Farët janë identifikuar në grafikon të rekrutimit me katrorë të mëdhenjë me ngjyrë të kaltër dhe kanë shigjeta që shkojnë në drejtim larg tyre e jo në drejtim kah ato.

Figura 2. Grafikoni i rekrutimit të mostrës së MSM (n=217), me pesë zingjirë të rekrutimit, Prishtinë, Kosovë, 2014.



Karakteristikat socio-demografike

Kategoria më e madhe e MSM kanë qenë nën moshën 25 vjeçare, kanë përfunduar shkollën e mesme dhe kanë qenë beqar (Tabela 3). Në mesin e atyre prej 34% të cilët kanë raportuar se janë të martuar ose 17% e atyre që kanë raportuar se janë në lidhje të qëndrueshme, gati 70% e tyre jetojnë me bashkëshorten ose partnerin e tyre. Pak mbi 50% e MSM kanë pas ndonjë lloj pune, por mesatarja e të ardhurave mujore për më shumë se 50% të MSM ka qenë <100 Euro. Gati të gjithë MSM, sipas gjinisë e kanë konsideruar gjininë e vet si mashkullore, por megjithatë 14% e tyre e kanë konsideruar veten qoftë si femër ose transseksual. Shumica e MSM janë vetë identifikuar si biseksual.

Tabela 3. Karakteristikat socio-demografike të MSM

	N	%	95% CI
Grup mosha			
18-24	113	43.7	34.6, 52.7
25-29	44	22.2	14.2, 30.3
30-39	37	19.1	11.6, 26.7
40-49	16	10.5	4.1, 16.9
50+	7	4.4	0.8, 8.06
Grup mosha			
≤ 24	113	43.7	34.5, 52.8
≥ 25	104	56.3	47.3, 65.5
Mediana e moshës (min., max.)mosha në vite		25 (18 – 64)	
Edukimi			
Asnjë edukim formal	29	12.0	6.3, 17.6
Fillor	46	23.0	15.2, 30.7
Mesëm	105	46.0	37.1, 55.0
Kolegj/universitet	37	19.0	10.1, 27.3
Statusi civil			
Martuar	52	33.6	24.2, 43.0
Lidhje të qëndrueshme /mashkull	44	11.0	6.4, 15.5
Lidhje të qëndrueshme/femër	14	6.0	1.8, 10.2
Beqar	106	49.4	40.0, 59.0
Jetojnë me bashkëshorte ose partner (në mesin a tyre të cilët janë të martuar/kanë partner)			
Po	57	68.8	58.2, 79.6
Jo	52	31.2	20.4, 41.8
Burimi i të ardhurave			
Puna e përhershme	76	34.6	28.8, 43.3

Puna e përkohshme/gjysmë orari	50	21.7	14.3, 29.1
Përkrahja familjare	91	43.7	34.6, 52.8
Të ardhurat mesatare mujore			
<100 EUR	117	55.1	45.3, 65.0
100-300 EUR	44	24.0	15.1, 32.8
300-400 EUR	54	20.9	13.6, 28.1
Gjinia			
Mashkull	189	85.8	79.0-92.3
Femër	17	7.5	2.2, 12.9
Transseksual	11	6.7	1.9, 11.5
Identiteti seksual i vetë raportuar			
Homoseksual	80	30.9	22.5, 39.2
Bi-seksual	137	69.1	60.8, 77.5
Tjetër	10	5.3	0.9, 9.8

Mobiliteti në 12 muajt e fundit

Mbi gjysma e MSM kanë raportuar se udhëtojnë jashtë Kosovës dhe gati 90% kanë raportuar se udhëtojnë jashtë Prishtinës. (Tabela 4). Kur ata udhëtojnë jashtë Kosovës, shumica e MSM kanë raportuar se udhëtojnë në vendet e Evropës, ku edhe përqindje afërsisht e barabartë kanë raportuar se kanë udhëtuar në Shqipëri, Maqedoni ose në vendet e tjera të Ballkanit. Rreth një e katërta e MSM kanë raportuar se kanë pas seks anal pa kondom kur udhëtojnë jashtë, ndërsa gati 40% kanë raportuar këtë kur udhëtojnë jashtë Prishtinës.

Tabela 4. Mobiliteti në mesin e MSM në 12 muajt e fundit, Prishtinë, 2014

	N	%	95% CI
Udhëtim jashtë Kosovës			
Po	124	55.1	45.6, 64.7
Jo	93	44.9	35.3, 54.4
Vendet e vizituara jashtë Kosovës në udhëtimin e fundit			
Shqipëri	32	23.8	12.8, 34.9
Maqedoni	26	24.4	12.2, 36.4
Ballkan	24	21.8	11.6, 32.1
Evropë	42	30.0	18.5, 41.4
Seks anal pa kondom sa kanë qenë jashtë			
Po	30	26.5	15.3, 37.6
Jo	94	73.5	62.3, 84.7
Udhëtim jashtë Prishtinës			

Po	196	89.8	84.1, 95.6
Jo	20	10.2	4.4, 15.9
Seks anal pa kondom jashtë Prishtinës			
Po	80	38.3	28.7, 47.9
Jo	117	61.7	52.1, 71.3

Sjelljet e përgjithshme seksuale

Mesatarja e moshës që kanë bërë seks anal për herë të parë me partner mashkull ka qenë 17 vjeç. Shumica e MSM kanë raportuar se praktikojnë vetëm seks anal aktiv (versus vetëm pasiv ose të dyja) (Tabela 5). MSM kanë raportuar një mesatare prej tre partnerëve seksual oral dhe tre partnerë seksual anal në 12 muajt e fundit. Një e katërta e MSM kanë raportuar se kanë marrë pjesë në seks grupor në 12 muajt e fundit dhe tri të katërtat kanë raportuar se kanë përdor kondom në seksin grupor të fundit.

Tabel 5. Sjelljet e përgjithshme seksuale në mesin e MSM, Prishtinë, 2014

	N*	%	95% CI
Mosha e seksit të parë anal me partner mashkull			
Mediana (min., max)		17 (7 – 40)	
Lloji i seksit anal të praktikuar në përgjithësi (pa afat kohor)			
Vetëm aktiv/insertiv	93	48.0	37.8, 58.4
Vetëm pasiv/receptiv	33	15.8	9.3, 22.4
Të dyja aktiv dhe pasiv	91	36.2	26.7, 45.4
Numri i partnerëve seksual oral meshkuj në 12 muajt e fundit			
Mediana (min., max)		3 (1 - 150)	
Numri i partnerëve seksual anal meshkuj në 12 muajt e fundit			
Mediana (min., max)		3 (1 –150)	
Seks grupor në 12 muajt e fundit			
Po	55	24.7	16.9, 32.4
Jo	161	75.3	67.6, 83.0
Përdorimi i kondomit në seksin grupor të fundit			
Po	40	73.2	55.6, 90.8
Jo	14	26.8	92.2, 44.4

Partnerët seksual meshkuj të qëndrueshëm

Në mesin e 52 MSM që kanë raportuar se kanë pas partner të qëndrueshëm në 12 muajt e fundit, 54% nuk e dijnë statusin e HIV të partnerit të tyre, 39% kanë pas seks me mashkull tjetër deri sa kanë qenë në lidhje të qëndrueshme në 12 muajt e fundit, 55% kanë raportuar

se përdorin lubrifikantë dhe 68% kanë raportuar se kanë përdor kondom herën e fundit kur kanë pas seks anal me partnerin e tyre të qëndrueshëm. (Tabela 6). Në mesin e 32% të MSM të cilët nuk kanë përdor kondom, 52% kanë raportuar se ‘ata i besojnë njëri tjetrit’ dhe 44% kanë raportuar se arsyeja kryesore është se atyre nuk iu pëlqen seksi me kondom.

Tabela 6. Partnerët e qëndrueshëm seksual mashkuj në mesin e MSM, Prishtinë, 2014

	N*	%	95% CI
Kanë pas partner të qëndrueshëm seksual në 12 muajt e fundit			
Po	134	51.9	42.1, 61.2
Jo	82	48.1	38.8, 57.9
E dijnë statusin e HIV të partnerit të fundit të qëndrueshëm			
Jo	78	54.1	40.6, 67.6
Po, ai është HIV-negativ	57	45.9	32.3, 59.3
Po, ai është HIV-pozitiv	--	--	--
Kanë pas seks anal me mashkull tjetër derisa kanë qenë në lidhje të qëndrueshme në 12 muajt e fundit			
Po	63	38.6	27.2, 49.8
Jo	71	61.4	50.2, 72.8
Kanë përdor lubrifikantë në marrëdhënien e fundit seksuale anale me partnerin e qëndrueshëm			
Po	77	54.8	43.3, 66.2
Jo	57	45.2	33.8, 56.7
Kanë përdor kondom në marrëdhënien e fundit seksuale anale me partnerin e qëndrueshëm			
Po	82	68.4	58.2, 78.7
Jo	52	31.6	21.3, 41.2
Arsyeja kryesore për mos përdorim të kondomit në marrëdhënien seksuale anale të fundit me partner të qëndrueshëm			
Nuk kemi pas kondom në dispozicion	3	4.1	0.2, 8.2
I besojnë njëri tjetrit	26	52.3	30.9, 73.9
Nuk iu pëlqen seksi me kondom	21	43.6	21.4, 65.7

Partnerët seksual të rastësishëm

Në mesin e MSM, 82% e të cilëve kanë raportuar se kanë pas seks anal me partner të rastësishëm në 12 muajt e fundit, 51% kanë raportuar se kanë përdor lubrifikantë dhe 76% kanë raportuar se kanë përdor kondom në marrëdhënien seksuale anale të fundit me

partner të rastësishëm (Tabela 7). Në mesin e 24% të MSM të cilët nuk kanë përdor kondom, 53% kanë raportuar se arsyeja kryesore është se ‘nuk iu pëlqen seksi me kondom’.

Tabela 7. Partnerët seksual të rastësishëm meshkuj në mesin e MSM, Prishtinë, 2014

	N*	%	95% CI
Kanë pas seks anal me partnerë të rastësishëm në 12 muajt e fundit			
Po	177	81.5	74.6, 88.5
Jo	38	18.5	11.5, 25.4
Kanë përdor lubrifikantë në seksin e fundit anal me partner të rastësishëm			
Po	100	50.8	39.9, 61.5
Jo	82	49.2	38.5, 60.1
Kanë përdor kondom në seksin e fundit anal me partner të rastësishëm			
Po	137	75.9	67.4, 84.4
Jo	43	24.1	15.6, 32.6
Arsyeja kryesore e mospërdorimit të kondomit në marrëdhënien e fundit anale me partner të rastësishëm			
Nuk kemi pas kondom në dispozicion	15	35.4	19.8, 51.0
I besojnë njëri tjetrit	4	11.8	3.7, 27.3
Nuk më pëlqen seksi me kondom	23	52.8	35.6, 67.0

Partnerët e paguar seksual (pjesëmarrësi ka paguar për seks)

Në mesin e MSM 7% e tyre kanë raportuar se kanë paguar një mashkull që të bëjë seks anal në 12 muajt e fundit, 47% kanë raportuar se kanë përdor lubrifikantë dhe 44% kanë raportuar se kanë përdor kondom në seksin e fundit anal me mashkull të cilin e kanë paguar për seks (Tabela 8). Në mesin e MSM, 56% e tyre kanë raportuar se nuk kanë përdor kondom, gjysma kanë raportuar se arsyeja ka qenë se ‘nuk iu pëlqen seksi me kondom’ dhe gjysma kanë raportuar se nuk kanë pas kondom në dispozicion.

Tabela 8. Partnerët seksual të paguar në mesin e MSM, Prishtinë, 2014

	N*	%	95% CI
Kanë pas seks anal me partnerët e paguar në 12 muajt e fundit			
Po	19	6.9	3.2, 10.6
Jo	197	93.1	89.4, 96.8
Kanë përdor lubrifikantë në seksin e fundit anal me partnerin e paguar			
Po	11	47.1	28.1, 65.6
Jo	6	52.9	34.4, 72.2
Kanë përdor kondom në seksin e fundit anal me partnerin e paguar			
Po	11	44.0	28.1, 59.7
Jo	5	56.0	40.2, 71.9
Arsyeja kryesore e mos përdorimit të kondom në seksin e fundit anal me partnerin e paguar			
Nuk kemi pas kondom në dispozicion	2	49.8	56.4, 94.0
Nuk iu pëlqen seksi me kondom	3	50.2	60.4, 94.3

Partnerët seksual meshkuj me pagesë (pjesëmarrësi ka marrë të holla për seks)

Njëzet e nëntë përqind e MSM kanë raportuar se janë paguar nga një mashkull për të bërë seks anal në 12 muajt e fundit, në mesin e të cilëve 47% kanë raportuar se kanë përdor lubrifikantë dhe 93% kanë raportuar se kanë përdor kondom në seksin e fundit anal me mashkull i cili i ka paguar ata për seks (Tabela 9). Në mesin e 7% të cilët nuk kanë përdor kondom, shumica kanë raportuar se atyre ose partnerit të tyre 'nuk i pëlqen seksi me kondom'.

Tabela 9. Partnerët seksual meshkuj me pagesë në mesin e MSM, Prishtinë, 2014

	N*	%	95% CI
Kanë pas seks anal me partnerë me pagesë në 12 muajt e fundit			
Po	71	28.8	20.2, 36.9
Jo	146	71.2	63.1, 79.4
Kanë përdor lubrifikantë në seksin e fundit anal me partner me pagesë			
Po	41	47.1	33.5, 60.6
Jo	30	52.9	39.4, 66.5
Kanë përdor kondom në seksin e fundit anal me partner me pagesë			
Po	64	93.2	88.1, 98.5
Jo	7	6.8	1.5, 11.9
Arsyeja kryesore e mospërdorimit të kondomit në seksin e fundit anal me partner me pagesë			
Nuk kanë pas kondom në dispozicion	2	18.6	4.5, 41.8
Partneri nuk është infeksioz	1	2.8	0.3, 5.3
Partnerit/pjesëmarrësit nuk i pëlqen seksi me kondom	5	78.6	55.4, 101.6

Partnerët seksual meshkuj të huaj

Në mesin e 33% të të cilëve kanë raportuar se kanë pas seks anal me partner të huaj në 12 muajt e fundit, 66% kanë raportuar se kanë përdor kondom në seksin e fundit anal me partner (Tabela 10). Shumica e MSM kanë raportuar se partneri seksual i huaj ka qenë nga Evropa.

Tabela 10. Partnerët seksual meshkuj të huaj në mesin e MSM, Prishtinë, 2014

	N*	%	95% CI
Kanë pas seks anal me partner të huaj në 12 muajt e fundit			
Po	81	33.0	24.5, 41.3
Jo	134	67.0	58.6, 75.5
Kanë përdor kondom në seksin e fundit anal me partner të huaj			
Po	49	66.0	51.3, 79.8
Jo	30	34.4	20.2, 48.7
Vendi i origjinës së partnerit seksual të fundit të huaj			
Shqipëri	8	9.4	0.6, 18.2
Maqedoni	6	13.2	2.9, 23.5
Ballkan	7	9.3	2.0, 16.6
Evropë	58	68.1	55.8, 80.2

Takimi i partnerëve seksual meshkuj

Gjysma e MSM kanë raportuar se i takojnë partnerët e ri seksual meshkuj në 12 muajt e fundit përmes internetit; gati gjysma e MSM raportojnë se e përdorin internetin një herë në javë ose më shumë (Tabela 11). Gati të gjithë MSM kanë raportuar se nuk shkojnë kurrë në vendet komerciale më të frekuentuara nga MSM dhe 56% kanë raportuar se nuk shkojnë kurrë në vendet publike që janë më të frekuentuara nga MSM.

Tabela 11. Takimi i partnerëve seksual meshkuj në 12 muajt e fundit në mesin e MSM, Prishtinë, 2014

	N*	%	95% CI
Mënyra më e shpeshtë e takimit të partnerëve të ri seksual meshkuj			
Personalisht	56	23.3	17.0, 29.7
Internet	103	49.8	40.4, 59.2
Përmes shokëve	32	14.6	8.7, 20.5
Nuk takoj partnerë për seks	25	12.3	5.8, 18.8
Shpeshtësia e shkuarjes në vendet komerciale të frekuentuara nga MSM			
Kurrë	210	97.5	95.3, 99.7

Ndonjëherë	6	2.1	0.01, 4.2
Një herë në javë ose më shumë	1	0.04	0.03, 1.0
Shpeshtësia e shkuarjes në vendet publike të frekuentuara nga MSM			
Kurrë	109	55.8	47.1, 64.8
Ndonjëherë	73	30.8	22.4, 39.0
Një herë në javë ose më shumë	35	13.4	8.1, 18.5
Shpeshtësia e përdorimit të internetit për të gjet partnerë seksual meshkuj			
Kurrë	66	33.2	24.4, 42.1
Ndonjëherë	46	21.0	12.9, 29.1
Një herë në javë ose më shumë	105	45.8	35.1, 56.4

Seksi me femra

Tetëdhjetë përqind e MSM kanë raportuar se kanë pas ndonjëherë seks vaginal ose anal me femër (Tabela 12). MSM që kanë raportuar se kanë pas në mesatare dy partnere seksuale femra (në mes 1 dhe 200) në 12 muajt e fundit; gjysma kanë raportuar se kanë përdor kondom me partneren seksuale të fundit femër në 12 muajt e fundit.

Tabela 12. Seksi me femra në mesin e MSM, Prishtinë, 2014

	N*	%	95% CI
Ndonjëherë kanë pas seks vaginal ose anal me femra			
Po	169	80.3	72.6, 88.1
Jo	48	19.7	11.9, 27.3
Numri mesatar i partnereve seksuale femra (min., max.) në 12 muajt e fundit 2 (1-200)			
K kanë përdor kondom në seksin e fundit me femër në 12 muajt e fundit			
Po	75	50.0	39.5, 60.3
Jo	65	50.0	39.7, 60.5

Përdorimi i kondomit dhe lubrifikantëve në përgjithësi

Shumica e MSM kanë raportuar se gjithmonë e përdorin kondomin në seksin anal të fundit në 12 muajt e fundit dhe 70% kanë raportuar se kanë përdor kondom herën e fundit që kanë pas seks. (Tabela 13). Më pak se një e katërta e MSM kanë raportuar se kanë përjetuar shqyerje të kondomit në 12 muajt e fundit. Katërdhjetë përqind e MSM kanë raportuar se kanë përdor gjithmonë lubrifikantë për seks anal në 12 muajt e fundit, megjithatë vetëm 2% kanë raportuar se kanë përdor lubrifikantë me bazë ujore në marrëdhënien e fundit seksuale anale.

Tabela 13. Përdorimi i kondomit dhe lubrifikantëve në përgjithësi në mesin e MSM, Prishtinë, 2014

	N*	%	95% CI
Shpeshtësia e përdorimit të kondomit për seks anal 12 muajt e fundit			
Gjithmonë	150	69.4	61.1, 77.6
Ndonjëherë	42	19.4	12.2, 26.6
Rrallë/kurrë	25	11.2	5.9, 16.5
Kanë përdor kondom në marrëdhënien e fundit anale			
Po	144	70.3	62.2, 78.5
Jo	73	29.7	21.5, 37.8
Kanë përjetuar shqyerjen e kondomit në 12 muajt e fundit			
Po	58	21.8	14.6, 29.0
Jo	150	78.2	71.0, 85.4
Shpeshtësia e përdorimit të lubrifikantit për seks anal 12 muajt e fundit			
Gjithmonë	98	41.0	31.6, 50.3
Ndonjëherë	50	22.1	14.6, 29.6
Rrallë/kurrë	69	36.9	28.2, 45.7
Llojet e lubrifikantëve që janë përdor më shpesh për seks anal në 12 muajt e fundit			
Kremë trupi/ losion për duar	210	97.5	95.3, 99.7
Lubrifikantë me bazë ujore (Durex)	6	2.1	0.001, 4.2
Tjetër	1	0.4	0.3, 1.0

Përdorimi i alkoolit, drogës dhe praktikat e injektimit në 12 muajt e fundit

Njëzet përqind e MSM kanë raportuar se kanë përdor alkool dhe 6% kanë raportuar se kanë përdor marihuanë rregullisht në 12 muajt e fundit (Tabela 14). Vetëm disa MSM kanë raportuar se kanë përdor Kokainë, Amfetaminë, Amyl nitrate, droga halucinogjene ose diazepam. Vetëm dy MSM kanë raportuar se kanë injektuar drogë; këta pjesëmarrës kanë raportuar se kanë injektuar heroinë ndonjëherë.

Tabela 14. Përdorimi i alkoolit/drogës dhe praktikat e injektimit në 12 muajt e fundit në mesin e MSM, Prishtinë 2014

	N*	%	95% CI
Alkool			
Kurrë	120	67.1	59.0, 75.4
Një herë në javë	32	12.7	7.2, 18.1
Rregullisht	43	20.2	13.1, 27.1
Kokainë			
Kurrë	210	95.9	92.0, 99.8
Një herë në javë	4	2.6	0.8, 6.1
Rregullisht	3	1.4	0.5, 3.3
Amfetaminë			
Kurrë	212	97.0	93.2, 100.0
Një herë në javë	5	3.0	0.5, 6.7
Rregullisht	--	--	--
Marihuanë			
Kurrë	181	86.8	81.2, 92.4
Një herë në javë	16	7.3	2.4, 12.1
Rregullisht	20	5.9	2.2, 0.9
Amil nitrate			
Kurrë	208	95.6	91.5, 99.6
Një herë në javë	7	4.1	0.1, 8.1
Rregullisht	2	0.3	0.01, 0.5
Droga halucinogjene			
Kurrë	215	98.2	95.7, 100.0
Një herë në javë	2	1.8	0.07, 4.3
Rregullisht	--	--	--
Diazepam			
Kurrë	215	98.5	97.1, 99.9
Një herë në javë	1	0.5	0.2, 1.0
Rregullisht	1	0.9	0.3, 2.1
Heroinë			
Kurrë	215	99.3	98.2, 100.0

Një herë në javë	2	0.7	0.4, 1.8
Rregullisht	--	--	--
Droga injektuese			
Po	2	0.7	0.5, 1.9
Jo	212	99.3	98.1, 100.0

Stigma, diskriminimi dhe dhuna

Vetëm disa MSM kanë qenë ndonjëherë të sulmuar fizikisht ose të abuzuar verbalisht nga policia për shkak se janë MSM (Tabela 15). Megjithatë, 28% kanë qenë ndonjëherë të abuzuar verbalisht për shkak se janë MSM. Trembëdhjetë përqind e MSM kanë raportuar se kanë qenë të burgosur një herë. Vetëm 29% e MSM kanë raportuar se dikush nga familja e tyre e di që ata bëjnë seks me meshkuj dhe 52% kanë raportuar se shoku i afërt që nuk është MSM e di që ata bëjnë seks me meshkuj. Pak më shumë se 7% e MSM kanë raportuar se janë detyruar të bëjnë seks në 12 muajt e fundit.

Tabela 15. Stigma, diskriminimi dhe dhuna në mesin e MSM, Prishtinë, 2014

	N*	%	95% CI
Ndonjëherë kanë qenë të sulmuar fizikisht për shkak se janë MSM			
Po, një herë	17	6.0	2.4,9.6
Po, disa herë	17	4.5	0.8,7.9
Jo	183	89.4	84.5,94.5
Ndonjëherë janë abuzuar verbalisht për shkak se janë MSM			
Po, një herë	14	5.9	1.6,10.2
Po, disa herë	84	27.6	19.6,35.3
Jo	119	66.3	57.9,75.0
Ndonjëherë kanë qenë të sulmuar fizikisht ose të abuzuar verbalisht nga policia për shkak se janë MSM			
Po, një herë	6	1.0	0.1,2.0
Po, disa herë	4	1.3	0.4,3.1
Jo	207	97.5	95.5,99.3
Ndonjëherë janë burgosur			
Po, një herë	26	12.9	6.2,19.7
Po, disa herë	15	4.7	1.8,7.5
Jo	176	82.2	75.1,89.4
Dikush në familje e di që ai/ajo është MSM			
Po	71	28.6	20.1,37.1
Jo	145	71.3	62.8,79.8
Shok i afërt jo MSM e di që ai/ajo është MSM			
Po	131	51.5	42.0,61.0
Jo	85	48.4	38.9,57.9
Është detyruar të bëjë marrëdhënie seksuale në 12 muajt e fundit			
Po	19	7.5	3.3,11.8
Jo	198	92.4	88.1,96.6

Shenjat dhe simptomet e IST në 12 muajt e fundit

Nëntë përqind e MSM kanë raportuar se kanë pas sekrecion gjenital, 2.8% kanë raportuar djegie gjatë urinimit dhe 0.5% kanë raportuar ulçera ose varrë gjenitale, 5.2% kanë raportuar edemë të perineumit dhe 4.3% kanë raportuar ulçera ose varrë anale në 12 muajt e fundit (Tabela 16). Në mesin e atyre që kanë raportuar se kanë pas simptome të IST në 12 muajt e fundit, 55% nuk kanë kërkuar ndihmë profesionale dhe 14% kanë kërkuar ndihmë në barnatore. Pesë përqind e MSM janë diagnostikuar me IST në 12 muajt e fundit.

Tabela 16. Shenjat dhe simptomet e IST në 12 muajt e fundit në mesin e MSM, Prishtinë, 2014

	N*	%	95% CI
Simptomet e IST			
Sekrecion gjenital			
Po	21	8.7	3.7,13.6
Jo	195	91.2	86.3,96.2
Djegje gjatë urinimit			
Po	61	2.8	2.0,36.8
Jo	156	7.1	63.1,79.3
Ulçera/varrë gjenitale			
Po	2	0.5	0.2,1.2
Jo	215	99.4	98.7,100.2
Edemë e perineumit			
Po	15	5.2	2.0,8.4
Jo	202	94.7	91.5,97.9
Ulçera/varrë anale			
Po	8	4.3	1.2,7.5
Jo	208	95.6	92.4,98.7
Kanë kërkuar ndihmë profesionale për simptomet e IST			
Po, te mjeku privat	5	10.2	0.1,20.5
Po, te mjeku publik	18	19.9	6.0,33.9
Asnjë ndihmë	40	55.5	40.4,70.6
Vetë mjekim (nga barnatorja)	14	14.3	5.3,23.1
Diagnostikuar me IST			
Po	11	4.7	1.6,7.8
Jo	206	95.2	92.1,98.3

Njohuritë për HIV

Një e katërta e MSM kanë njohuri të sakta për bartjen e HIV bazuar në grupin e përgjigjeve të sakta në pesë pyetjet mbi njohuritë për HIV (Tabela 17). Gati të gjithë MSM kanë raportuar se e dijnë që të bësh seks me vetëm një partner të besueshëm, partner të painfektuar dhe përdorimi korrekt i kondomit çdo herë gjatë seksit anal, janë masa mbrojtëse kundër infeksionit me HIV. Shumica e MSM poashtu e dijnë që HIV mund të bartet përmes përdorimit të gjilpërave/shiringave që i ka përdor dikush tjetër më parë dhe se një person në dukje i shëndoshë mund të ketë HIV. Mirëpo, më shumë se 35% e MSM kanë besuar se mund të infektohen me HIV nëse shfrytëzojnë të njëjtin toalet, përmes pickimit të mushkonjave dhe duke e ndarë ushqimin me dikë që është i infektuar me HIV. Shtatëmbëdhjetë për qind e MSM kanë raportuar se e njohin dikë që ka vdekur nga AIDS, por 39% besojnë se ata nuk janë në rrezik për t'u infektuar me HIV.

Tabla 17. Njohuritë për HIV në mesin e MSM, Prishtinë, 2014

	N*	%	95% CI
Kanë njohuri të sakta për bartjen e HIV			
Po	60	25.4	16.7,34.0
Jo	157	74.6	66.0,83.3
Seksi me vetëm një partner të besueshëm, të painfektuar zvogëlon rrezikun e bartjes së HIV			
Po	169	81.4	74.9,87.9
Jo	48	18.5	12.0,25.0
Përdorimi i drejtë i kondomit çdo herë gjatë seksit anal mund të mbrojë nga infektimi me HIV			
Po	203	95.9	93.1,98.8
Jo	14	4.0	1.1,6.8
HIV mund të bartet përmes përdorimit të gjilpërave dhe/ose shiringave të përdorura më parë nga dikush tjetër			
Po	192	87.1	80.0,94.2
Jo	25	12.8	5.7,19.9
Personi në dukje i shëndoshë mund të ketë HIV			
Po	189	86.4	80.3,92.4
Jo	28	13.5	7.5,19.6
HIV mund të merret përmes përdorimit të përbashkët të toaletit me një person që është i infektuar me HIV			
Po	93	42.8	33.5,52.2
Jo	124	57.1	47.7,66.5

Një person mund ta merr HIV nga pickimi i mushkonjave

Po	93	39.1	30.6,47.8
Jo	126	60.8	52.2,69.3

Një person mund të merr HIV duke e ndarë ushqimin me dikë që është i infektuar me

HIV

Po	72	39.4	30.4,48.5
Jo	145	60.6	51.5,69.5

E njeh dikë që është i infektuar ose ka vdekur nga HIV

Po	43	17.3	10.7,24.5
Jo	174	82.6	75.5,89.8

Percepton rrezikun e infektimit

Pa rrezik	73	39.3	29.8,48.9
Rrezik i ulët	61	27.7	19.5,35.9
Rrezik mesatar	56	21.9	14.7,29.1
Rrezik i lartë	27	11.0	5.7,16.3

Testimi në HIV

Shumë MSM e dijnë se ku mund të testohen për HIV, 73% janë testuar ndonjëherë, në mesin e të cilëve 47% janë testuar në 12 muajt e fundit (Tabela 18). Në mesin e atyre që janë testuar në 12 muajt e fundit, 93% i kanë marrë rezultatet e tyre nga testimi i tyre i fundit dhe në mesin e atyre që janë testuar ndonjëherë, 69% janë testuar dhe i kanë marrë rezultatet e tyre në 12 muajt e fundit.

Tabela 18. Testimi në HIV në mesin e MSM, Prishtinë, 2014

	N*	%	95% CI
Mund të testohen në HIV në Prishtinë			
Po	187	90.8	86.4,95.3
Jo	30	9.1	4.6,13.6
Janë testuar ndonjëherë në HIV			
Po	160	72.7	64.0,81.5
Jo	56	27.2	18.5,36.0
Janë testuar në HIV në 12 muajt e fundit (në mesin e atyre që janë testuar ndonjëherë)			
Po	79	46.5	35.2,57.7
Jo	83	53.5	42.3,64.8
I kanë marrë rezultatet e testit të fundit (në mesin e atyre që janë testuar në 12 muajt e fundit)			
Po	149	92.7	87.9,97.4
Jo	11	7.3	2.5,12.0
Janë testuar në HIV në 12 muajt e fundit (në mesin e të gjithë pjesëmarrësve)			
Po	149	66.8	57.0,76.6
Jo	68	33.1	23.3,42.9
Pjesëmarrësi e ka marrë rezultatin e testit të HIV në testimin e fundit			
Negativ	149	95.3	90.0,100.5
Refuzon të përgjigjet	3	4.6	0.5,9.9

Kondomi dhe programet e parandalimit

Gati të gjithë MSM kanë raportuar se ata mund të marrin kondoma kur iu nevojiten dhe 74% kanë raportuar se kanë marrë kondoma falas në 12 muajt e fundit (Tabela 19). Pesëmbëdhjetë përqind e MSM kanë raportuar se kanë marrë informata për HIV ose seks të sigurtë dhe vetëm 0.5% kanë raportuar që kanë marrë shërbime në peer edukim.

Tabela 19. Kondomi dhe programet e parandalimit në mesin e MSM, Prishtinë, 2014

	N*	%	95% CI
Mund të marrin kondoma kur iu duhen			
Po	207	94.9	91.1,98.6
Jo	6	3.4	0.3,6.5
Nuk përdorin kondom	3	1.5	0.5,3.7
Arsyeja pse nuk kanë marrë kondoma			
Shumë shtrenjtë	3	32.5	2.9,61.4
Dyqani/barnatorja shumë larg	1	25.2	15.1,66.0
Turpërohen të blejnë kondoma	2	42.2	0.01,84.7
Kanë marrë kondoma falas në 12 muajt e fundit			
Po	166	73.5	65.4,81.4
Jo	51	26.5	18.5,34.5
Herën e fundit kanë marrë informata për HIV ose seks të sigurtë			
Muajin e fundit	83	34.6	24.7,44.7
Vitin e fundit	61	29.3	20.7,38.1
Para një viti	36	20.7	13.1,28.4
Kurrë	36	15.2	8.6,21.8
Kanë marrë shërbime të peer edukimit			
Po	5	0.7	0.2,1.7
Jo	212	99.2	98.2,100.2

Prevalenca e HIV, HBV dhe Sifilisit

Prevalenca e HIV në mesin e MSM ka qenë 0.5%, prania e HBsAg (HBV infeksioz) ka qenë 5.6%, prania e AntiHBsAg (mund të jetë tregues për vaksinim ose kontakt me HBV) ka qenë 27.9%, infeksioni sekondar me sifilis ka qenë 2% dhe kontakt i freskët me *Treponema pallidum* (shkaktari i sifilisit) ka qenë 2.7%.

Tabela 20. Prevalenca e HIV, HBV dhe sifilisit në mesin e MSM, Prishtinë, 2014

Prevalenca e sëmundjes	N*	%	95% CI
HIV			
Negativ	212	99.4	98.8,100.0
Pozitiv	5	0.5	0.07,1.1
HBV (HBsAg)			
Negativ	207	94.3	90.2,98.4
Pozitiv	10	5.6	1.5,9.7
HBV (AntiHBsAg)			
Negativ	165	72.0	63.4,80.5
Pozitiv	52	27.9	19.1,36.1
Sifilis (IgG)			
Negativ	212	97.8	95.4,100.1
Pozitiv	5	2.1	0.1,4.5
Sifilis (IgM)			
Negativ	208	97.3	95.1,99.7
Pozitiv	9	2.7	0.3,4.9

VLERËSIMET E MADHËSISË SË POPULLATËS PËR MSM

Objekti unik

Një javë para fillimit të studimit, 432 objekte unike (varëse çelësash) janë shpërndarë nga punëtorët e terrenit tek MSM në Prishtinë. Vlerësimi i peshuar për ata të cilët janë përgjigjur se e kanë marrë objektin unik ka qenë 0.9% në mesin e MSM në Prishtinë (Tabela 21). Në bazë të rezultateve të shumëzimit të objektit unik, vlerësimi përfundimtar i madhësisë së popullatës për MSM në Prishtinë është 4,800.

Tabela 21. Vlerësimet e madhësisë së popullatës të MSM në Prishtinë përmes metodës së shumëzimit të objektit unik

	MSM Prishtinë
Numri i objekteve unike të shpërndara	432
Përqindja ¹⁴ e atyre që kanë raportuar se e kanë marrë objektin unik	0.9%
Llogaritja	$432 / .09 =$
Madhësia e popullatës	4,800
Gabimi standard	0.03
95% Kufijtë e konfidencës	1,623-7,969

Shumëzimi i shërbimit për testim në HIV

Numri i vizitave unike nga MSM në Prishtinë për KTV gjashtë muaj para studimit ka qenë 139 (Tabela 22). Përqindja e MSM që kanë raportuar se kanë marrë shërbime të KTV nga CSGD gjatë periudhës së njëjtë ka qenë 17%. Rezultati i madhësisë së popullatës që kanë marrë shërbime të KTV përmes shumëzimit të shërbimeve është 818 për MSM në Prishtinë. Ka mundësi që këto rezultate janë të nën prezantuara për shkak të cenimit të supozimit të jopavarësisë në mes të shërbimit dhe studimit (p.sh. personat të cilët kanë marrë shërbime

¹⁴Përqindjet janë peshuar me RDSAnalyst përmes vlerësuesit të mostrimit suksesiv.

të KTV kanë më shumë gjasa që të marrin këtë shërbim pasi që studimi është mbajtur në të njëjtin vend ku edhe ofrohet shërbimi).

Tabela 22. Vlerësimet e madhësisë së popullatës të MSM në Prishtinë përmes metodës së shumëzimit të shërbimit për testim në HIV

	MSM Prishtinë
Numri i vizitave unike për KTV	139
Përqindja ¹⁵ e atyre që kanë raportuar se janë testuar në HIV	17%
Llogaritja	$139/.17 =$
Madhësia e popullatës	818
Gabimi standard	.04
95% Kufijtë e konfidencës	418, 1219

Shumëzimi i shërbimit për shpërndarje të kondomave

Numri i kondomëve të shpërndarë për një MSM në Prishtinë gjashtë muaj para studimit ka qenë 738 dhe përqindja e atyre që kanë raportuar se kanë marrë kondoma gjatë periudhës së njëjtë ka qenë 67%, që ka rezultuar me vlerësim të madhësisë së popullatës prej 1,102 MSM (Tabela 23).

Tabela 23. Vlerësimet e madhësisë së popullatës të MSM në Prishtinë përmes shumëzimit të shpërndarjes së kondomëve

	MSM in Prishtinë
Numri i kondomëve të shpërndarë tek një person	738
Përqindja ¹⁶ e atyre që kanë raportuar që kanë marrë kondom	67%
Llogaritja	$738/.67 =$
Madhësia e popullatës	1,102
Gabimi standard	0.05
95% Kufijtë e konfidencës	932 1,282

¹⁵Ibid.

¹⁶Ibid

Madhësia e mostrës suksesive (SS-Size)

Rezultatet e madhësisë së mostrës suksesive janë mesatarja, mediana dhe modi si dhe kufijtë e konfidencës (Tabela 24). Të dhënat përfshijnë numrin minimal (madhësia e mostrës) dhe numrin maksimal bazuar në të gjeturat nga shumëzimet e objektit unik. Mesatarja është vlerësimi më i mirë për madhësitë e popullatës.

Tabela 24. Vlerësimet e madhësisë së popullatës të MSM në Prishtinë përmes shumëzimit të shërbimit pët testim në HIV

MSM Prishtinë	
Mesatarja, Mediana, Modi	5628, 3498, 1486
Kufijtë e besueshmërisë	418-1,219

Mençuria e grupit

Tabela më poshtë tregon vlerësimet e ndryshme të dhëna nga pjesëmarrësit MSM në studim në Prishtinë (Tabela 25). Vlerësimi më i saktë i mundshëm i madhësisë i raportuar nga MSM ka qenë 1,634.

Tabela 25. Vlerësimet e madhësisë së popullatës të MSM në Prishtinë përmes mençurisë së grupit

MSM Prishtinë	
Mesatarja më e ulët e mundshme	978
Mesatarja më e lartë e mundshme	2,196
Mesatarja më e saktë e mundshme	1,634

Vlerësimi përfundimtar i madhësisë së popullatës

Janë disa dallime të mëdha në mes të shumëzimit. Disa nga këto të gjetura duhet të shfrytëzohen vetëm si 'pikë referente' për triangulim të vlerësimeve më të besueshme të madhësisë së popullatës (Tabela 26). Është e mundshme që shumëzimi i shërbimeve të KTV i cili ka rezultuar me madhësi të popullatës prej 818 MSM ka treguar nënvlerësim për shkak

të supozimit të cenimit të pavarësisë. Përzgjedhja e mesatares së vlerësimeve tjera të madhësisë së popullatës mund të ofroj vlerësime më reale të 5,214 MSM në Prishtinë. Nëse ne e vlerësojmë se janë afërsisht 81,000¹⁷ meshkuj të moshës madhore në Prishtinë dhe se 5,200 bëjnë seks me meshkuj, ne mund të themi se 6.4% e meshkujve të moshës madhore bëjnë seks me meshkuj. Nëse e bëjmë llogaritjen e tërë popullatës së meshkujve të moshës madhore në Kosovë (713, 000) ne mund të themi se 45, 632 meshkuj në Kosovë bëjnë seks me meshkuj.

Një skenar tjetër është të merret mesatarja e të gjitha vlerësimeve e cila rezulton me 2,796 MSM. Ngjajshëm me atë më lartë, nëse ne e vlerësojmë se janë mesatarisht 81,000 meshkuj të moshës madhore në Prishtinë dhe se 2,796 bëjnë seks me meshkuj, ne mund të themi se 3.5% e meshkujve të moshës madhore bëjnë seks me meshkuj. Nëse e bëjmë këtë llogaritje për popullatën e përgjithshme të meshkujve të moshës madhore në Kosovë (713, 000) ne mund të themi se 24, 955 meshkuj në Kosovë bëjnë seks me meshkuj.

Tabela 26. Vlerësimet përfundimtare më reale për vlerësimet e madhësisë së popullatës së MSM në Prishtinë

Qyteti	Objekti unik	Shumëzimi i shërbimit-KTV	Shumëzimi i shërbimit-kondomi	Mençuria e grupit (mesatarja)	e SS madhësia	Vlerësimet më të mira finale
MSM Prishtinë	4,800	818	1,102	1,634	5,628	5,214

¹⁷ E llogaritur duke marrë 49% të popullatës së përgjithshme në Prishtinë (205,133) dhe Kosovë (1,815,606) të parashikuar në vitin 2012 dhe duke zbritur 23% për të llogarit popullatën nën 18 vjeç. Të dhënat e marra nga <http://ask.rks-gov.net/eng/>.

DISKUTIMI DHE REKOMANDIMET

Sjelljet seksuale me rrezik të lartë

Shumica e MSM kanë shumë partnerë ose janë në lidhje njëkohësisht me partnerë të ndryshëm, “të qëndrueshëm”, “të rastësishëm”, “komercial” dhe partnerë meshkuj të huaj dhe partnere femra. Përdorimi i kondomit nuk ka qenë i rregullt me cilindo nga të gjithë partnerët. Një e katërta e MSM kanë raportuar se kanë bërë seks grupor në vitin e fundit në mesin e të cilëve 27% nuk kanë përdor kondom gjatë seksit grupor të fundit. Përdorimi jo i rregullt i kondomit dhe partnerëve të shumtë seksual meshkuj dhe femra, përfshirja në seksin komercial, mund të nxjerr në pah disa mundësi për bartjen e HIV dhe IST tek partnerët tjerë seksual meshkuj si dhe tek popullata e përgjithshme në Kosovë. Intervenimet për ndërrimin e sjelljeve dhe komunikimet kanë për qëllim zvogëlimin e numrit të partnerëve, njohjen e statusit të HIV para se të bëjnë seks dhe promovimin e përdorimit të kondomit në mesin e MSM janë nevojë urgjente. Arsyet që janë dhënë për mos përdorim të kondomit në seksin e fundit anal me mashkull kanë qenë sepse nuk kanë pas në dispozicion, nuk iu pëlqen dhe se ata i besojnë partnerit të tyre. Është e nevojshme të kemi më shumë njohuri të tjera në lidhje me situatën dhe kushtet nën të cilat meshkujt nuk përdorin kondom duke pas parasysh njohuritë e tyre për rrezikun e mundshëm për të mos bërë këtë.

Qasja në kondoma dhe shërbimet e peer edukimit

Shumica e MSM kanë raportuar se ata e dijnë se ku mund të marrin kondoma kur ata iu duhen. Edhe pse tri të katërtat e MSM kanë raportuar se marrin kondoma falas nga OJQ-të në 12 muajt e fundit, vetëm 0.7% kanë raportuar se kanë marrë shërbime të peer edukimit. Puna në terren ka kosto më të ulët dhe është metodë më efektive për edukimin dhe inkurajimin e MSM të përdorin kondom si dhe të testohen në HIV. Shërbimet e peer edukimit duhet të zgjerohen në tërë Kosovën.

Seksi i pambrojtur me femra

Tetëdhjetë përqind e MSM kanë raportuar se kanë pas seks vaginal me femra, në mesin e të cilëve gjysma nuk kanë përdor kondom në 12 muajt e fundit. Nuk dihet se partneret femra të MSM e dijnë se partnerët e tyre mashkuj bëjnë seks me meshkuj. Nuk dihet as se MSM të cilët bëjnë seks me femra a e bëjnë atë në mënyrë që të fshehin se ata nuk janë heteroseksual. Duke pas parasysh se MSM e përdorin shumë pak kondomin me partnerë femra (dhe meshkuj), duhen zhvilluar strategji për të zvogëluar bartjen e HIV në mesin e partnerëve intim përfshirë edhe fuqizimin e intervenimeve në parandalimin e HIV me theks në rëndësinë e mbrojtjes së partnerëve femra dhe meshkuj dhe hulumtimeve të mëtutjeshme për përmirësimin e të kuptuarit të dinamikës së bartjes së HIV në mesin e partnerëve intim.

Përdorimi i ulët i alkoolit dhe mesatar i drogës jo injektuese

Vetëm 20% e MSM kanë raportuar se përdorin rregulisht alkool dhe disa prej tyre kanë raportuar përdorimin e ndonjë droge. Vetëm dy MSM kanë raportuar që përdorin droga injektuese. Përkundër prevalencës aktuale të ulët të përdorimit të drogave injektuese në mesin e MSM, sjelljet e seksuale me rrezik të lartë dhe rrjeti i përdorimit të drogave duhet të vazhdoj të monitorohet edhe më tutje.

Njohuritë kontradiktore të bartjes së HIV

Vetëm një e katërta e MSM kanë njohuri të sakta për bartjen e HIV bazuar në grupin e pyetjeve të rekomanduar nga Raportimi Global i Përgjigjes së AIDS¹⁸ (GARPR). Rreth 40% e MSM kanë menduar jo saktë se HIV mund të përhapet përmes ulëses së përbashkët të toaletit, nga pickimi i mushkonjave dhe me ndarje të ushqimit. Megjithatë, gati të gjithë MSM e kanë dit se përdorimi i rregullt të kondomit çdo herë kur bëjnë seks mund t'i mbrojë nga infeksioni me HIV. Informatat e sakta për bartjen e HIV janë të rëndësishme për mbrojtjen e MSM dhe të tjerëve nga përhapja e HIV. Edukimi gjithëpërfshirës për HIV dhe

¹⁸ UNIADS. Global AIDS Response Progress Reporting 2014. Construction of Core Indicators for monitoring the 2011 United Nations Political Declaration on HIV and AIDS. http://www.unaids.org/en/media/unaids/contentassets/documents/document/2014/GARPR_2014_guidelines_en.pdf

seks të sigurtë duhet të filloj para shkollës së mesme, posaqërisht pasi që 23% e MSM kanë të kryer vetëm shkollën fillore. Duhet të eksplorohehen edhe metoda të tjera për zgjerimin e edukimit dhe seksit të sigurtë. Veç kësaj, do të ishte e dobishme të shfrytëzohen njohuritë pasi që PID kanë rrjete sociale të mëdha (siç është konfirmuar nga rekrutimi efektiv i PID në Prishtinë dhe Prizren) në shpërndarjen e parandalimit përmes modaliteteve intervenuese të udhëhequra nga kolegët (peer) e tyre.

Testimi mesatar në HIV

Më pak se tre të katërtat e MSM janë testuar në HIV dhe gati gjysma e tyre janë testuar në 12 muajt e fundit. Testimi i rregullt në HIV tek MSM të cilët praktikojnë sjellje seksuale me rrezik të lartë është esencial për të mbajtur nivelin e ulët të bartjes së HIV në Kosovë.

Diagnostikim i ulët i IST dhe infeksionit në sifilis

Vetëm 5% kanë raportuar se janë diagnostikuar me IST në 12 muajt e fundit dhe vetëm 3% kanë rezultuar pozitiv në sifilis aktiv.

Nivel i ulët dhe mesatar i abuzimit fizik dhe nivel i lartë i fshehjes

MSM në Kosovë vuajnë nga një nivel mesatar i abuzimit verbal (27.6% kanë raportuar se janë abuzuar verbalisht disa herë) dhe nivel i ulët i abuzimit fizik për arsye se njerëzit kanë besuar se pjesëmarrësi ka bërë seks me meshkuj tjerë. Nuk dihet se niveli i ulët dhe mesatar i abuzimit fizik dhe verbal ka lidhje me MSM në Prishtinë që janë të fshehur. Vetëm 29% e MSM kanë raportuar se anëtarët e familjes dhe 52% kanë raportuar se shoku i afërt që nuk është MSM e di që ai/ajo është MSM. Të gjitha këto të gjetura na sugjerojnë që MSM ballafaqohen me nivele të ndryshme të diskriminimit dhe stigmës në Kosovë. Ndjenja e të qenit i stigmatizuar dhe diskriminuar mund të rezultojnë në refuzim, izolim dhe depresion. Duhet hulumtuar më shumë në mesin e MSM për caktimin e metodave dhe burimeve të stigmatizimit dhe diskriminimit. Zgjerimi i programeve edukative dhe të ngritjes së vetëdijes në vazhdim mund të jenë të nevojshme për të zvogëluar abuzimet verbale dhe të tjera që bëhen ndaj tyre ose edhe popullatave “të ndryshme”.

Prevalenca e ulët e HIV

Në këtë studim është gjet HIV, edhe pse i ulët, në mesin e MSM në Prishtinë. Në studimet e vitit 2006 dhe 2011 nuk është gjet asnjë MSM me HIV. Shfaqja e HIV te kjo popullatë thekson nevojën e vazhdimit të monitorimit të HIV si dhe IST tjera, në mënyrë që të kontrollohet përhapja e mëtutjeshme. Prevalenca e sifilit dhe HBV ka qenë e ulët në këtë studim.

Vlerësimet e madhësisë së popullatës

Vlerësimet finale të madhësisë së popullatës janë ranguar nga 818 në 5,628. Me qëllim të ekstrapolimit për qytetin e Prishtinës dhe në shtetin e Kosovës, ne mund ta marrim rangun mesatar në mes të shumëzimit të objektit unik dhe madhësisë SS dhe është kalkuluar për madhësinë finale të popullatës në qytet prej 5,200 dhe madhësinë e popullatës në nivel vendi prej 45,632, e cila është rreth 6.4% e popullatës të gjinisë mashkullore të moshës madhore. Një alternativë tjetër është të shfrytëzohet rangi mesatar i të gjitha vlerësimeve që rezultojnë në madhësi të popullatës në nivel vendi prej 24,955 ose 3.5% e mbarë popullatës së gjinisë mashkullore. Të gjeturat nga teknikat e përdorura për vlerësim të madhësisë së popullatës duhet të interpretohen me kujdes dhe duhet të triangulohen me metoda të tjera për të nxjerrë vlerësimin më të saktë.

TË GJETURAT E STUDIMIT NË MESIN E PERSONAVE QË INJEKTOJNË DROGË

Përmbledhje

Gjatë periudhës gati tre mujore, që nga fillimi i korrikut 2014, 300 PID (përfshirë pesë farë) në Prishtinë dhe 199 PID (përfshirë katër farë) në Prizren janë rekrutuar në studim. Numri maksimal i valëve të arritura në zingjirin e rekrutimit ka qenë 14 në Prishtinë dhe në Prizren ka qenë 13 (shih grafikonet e rekrutimit, figura 3 dhe 4). Farët janë identifikuar në grafikonet të rekrutimit me katrorë të mëdhenjë ngjyrë hiri dhe i kanë shigjetat në drejtim të kundërt nga ata.

Figura 3. Grafikoni i rekrutimit të mostrës së PID (n=300) me pesë zingjirë rekrutimi, Prishtinë, Kosovë, 2014.





Figure 4. Grafikoni i rekrutimit të mostrës së PID (n=199) me pesë zingjirë rekrutimi, Prizren, Kosovë, 2014.



Karakteristikat socio-demografike

Shumica e PID në Prizren kanë qenë të rinjë (18 deri 24 vjeç) krahasuar me Prishtinë (Tabela 27). Gjashtë përqind në Prishtinë dhe 9% në Prizren kanë qenë femra. Shumica e PID në të dy qytetet kanë raportuar se kanë të kryer shkollimin e mesëm ose më shumë, që janë beqar/e, bashkëjetojnë dhe që janë të punësuar.

Tabela 27. Karakteristikat socio-demografike të PID, 2014

	Prishtinë			Prizren		
	N	%	95% CI	N	%	95% CI
Grup mosha						
18-24	85	32.7	24.4,41.9	107	57.9	48.4,68.6
25-29	76	23.4	16.8,29.6	36	17.2	9.7,24.2
30-39	88	28.9	21.7,35.7	38	16.9	10.9,22.6
40-49	42	13.2	7.75,18.7	18	7.8	2.1,13.1
50+	9	1.7	0.3,2.9	--	--	--
Grup mosha						
≤ 24	85	32.8	24.5,41.7	107	57.9	48.7,68.3
≥ 25	215	67.2	58.3,75.4	92	42.0	31.7,51.3
Mediana (Min.-Max.)	28 (18-69)			23 (18 -47)		
Gjinia						
Mashkull	282	94.3	90.6,98.1	184	91.4	85.6,96.9
Femër	18	5.67	1.8,9.4	15	8.5	3.1,14.3
Edukimi						
Asnjë edukim formal	38	12.1	6.5,17.8	2	1.4	0.3,3.3
Fillor	95	30.8	23.6,37.9	52	23.5	13.6,32.8
Të mesëm	143	47.2	38.6,55.8	114	63.3	54.7,73.7
Kolegj/universitet	24	9.7	4.4,15.3	31	11.5	6.2,15.9
Statusi martesor						
Martuar	98	28.7	21.7,35.1	37	16.4	8.9,23.3
Ndarë/vejë	39	9.9	5.5,13.7	3	1.4	0.2,3.1
Lidhje të qëndrueshme	21	7.7	3.8,11.7	36	22.3	13.9,31.3
Beqar/e	141	53.6	46.4,61.8	123	60.1	50.6,69.0
Jetojnë në tre muajt e fundit						
Në shtëpi të tyre	128	41.1	33.6,48.3	69	33.5	23.6,43.5
Privat (në shtëpinë e dikujt tjetër)	156	53.4	46.3,60.8	128	66.2	56.3,76.2
Vend publik (rrugë/park)	16	5.4	1.7,9.1	2	0.3	0.08,0.5
Burimi i të ardhurave në muajin e fundit						
Asnjë të ardhur	88	27.0	19.0,34.6	6	1.6	0.009,2.9
Punësuar	109	42.1	34.4,50.8	107	56.6	47.5,66.5

Të joformale/ilegale	hyra	103	30.8	23.6,37.3	86	41.7	32.0,50.9
-------------------------	------	-----	------	-----------	----	------	-----------

Përdorimi i drogës në përgjithësi

Gati 100% e PID në Prishtinë dhe 85% në Prizren kanë përdor ndonjëherë heroin dhe 56% në Prishtinë dhe 55% në Prizren kanë përdor heroin në muajin e fundit (Tabela 28).

Tabela 28. Përdorimi i drogës në përgjithësi në mesin e PID, 2014

	N	%	95% CI	N	%	95% CI
	Prishtinë			Prizren		
Drogat e përdorura ndonjëherë						
Heroin	297	99.3	98.7,1.0	169	84.6	77.6,91.4
Kokain	125	34.3	26.3,40.9	133	66.6	57.8,75.5
Heroin/kokain bashkë	95	22.1	15.7,26.7	54	22.2	14.1,29.0
Amfetaminë	35	0.9	0.5,13.7	36	16.1	9.8,22.0
Morfin	45	11.9	0.7,16.2	23	8.3	3.8,11.9
Opium	33	0.7	0.4,10.9	45	25.5	18.4,33.4
Metadon	223	66.3	57.7,73.4	133	65.1	55.5,74.1
Diazepam	181	53.6	45.4,60.5	125	55.9	46.0,63.9
Drogat e përdorura në muajin e fundit						
Heroin	148	56.4	49.5,64.5	108	54.9	45.0,64.9
Heroin/kokainë bashkë	6	0.8	0.002,1.4	33	20.6	12.8,29.5
Metadon	144	41.7	33.7,48.7	48	18.0	10.0,24.3
Tjetër	2	1.0	0.5,2.6	10	6.4	2.0,11.2

Praktikat e injektimit

Mesatarja e moshës së injektimit të parë në Prishtinë ka qenë 20 dhe në Prizren ka qenë 18 vjeç (Tabela 29). Shumica e PID në të dyja qytetet kanë raportuar që injektojnë një herë ose më shumë në ditë një ditë para se të hyjnë në studim. Shumica e PID në Prishtinë kanë raportuar se ata e injektojnë në shtëpi (73%), ndërsa shumica e PID në Prizren kanë raportuar se e injektojnë drogën në sajte (40%), dhe në shtëpi (38%). Gjashtëdhjetë e tre përqind në Prishtinë dhe 45% në Prizren kanë raportuar se kanë qenë me një mesatare prej dy personave tjerë herën e fundit kur kanë injektuar drogë.

Tabela 29. Praktikat e injektimit në mesin e PID, 2014

	N	%	95% CI	N	%	95% CI
	Prishtinë			Prizren		
Mosha mesatare e injektimit të parë në vite (Min.-Max.)	20 (12-50)			18(10-39)		
Shpeshtësia e injektimit në muajin e fundit						
Një herë në ditë ose më shumë	159	61.9	55.3,70.1	76	48.4	40.4,59.1
Një herë ose më shumë në javë	53	16.3	10.6,21.7	74	29.3	20.5,36.0
Një herë ose më shumë në muaj	88	21.7	15.1,27.2	49	22.3	15.4,28.6
Kanë injektuar një ditë më parë						
Po	175	70.3	65.5,76.9	108	62.1	54.9,71.2
Jo	124	29.7	23.1,34.4	91	37.9	28.8,45.0
Mesatarja e injektimeve një ditë më parë (Min.-Max.)	1 (1-13)			1 (1-7)		
Vendet ku pjesëmarrësi ka injektuar drogë në muajin e fundit						
Në shtëpi	213	72.6	66.3,79.2	77	37.5	28.7,45.9
Shtëpi private	25	9.7	4.9,14.6	12	5.9	2.1,9.7
Vend publik	30	7.5	3.9,10.8	39	16.2	9.2,22.2
Sajt	31	10.0	5.7,14.3	71	40.4	31.3,50.7
Persona tjerë poashtu kanë injektuar drogë gjatë injektimit të fundit						
Po	176	62.5	55.8,69.7	83	45.4	36.5,55.2
Jo	123	37.5	30.2,44.1	116	54.5	44.7,63.4
Mediana numri i personave që kanë injektuar drogë në injektimin e fundit (Min.-Max.)	2 (1-25)			2 (1-5)		

Shkëmbimi i gjilpërave dhe shiringave në muajin e fundit

Edhe pse përqindjet e përgjithshme kanë qenë të ulëta, përqindje më e lartë e PID në Prishtinë se sa në Prizren, kanë raportuar se kanë përdor gjilpëra dhe shiringa të cilat i ka përdor dikush tjetër më parë (Tabela 30). Shumica e PID në Prishtinë kanë raportuar se kanë shkëmbyer gjilpërat dhe shiringat me shokët ose të afërmit dhe në Prizren kanë raportuar se i kanë shkëmbyer me familjarë ose partnerë seksual. Përqindja e përdorimit të filterit/pambukut, lugës/enës dhe ujit të cilin e ka përdor dikush tjetër më parë ka qenë më e lartë në Prishtinë se sa në Prizren. Gjashtëmbëdhjetë përqind e PID në Prishtinë dhe 3% në Prizren kanë raportuar se të tjerët i kanë përdor gjilpërat ose shiringat që pjesëmarrësi i ka përdor vet më parë. Personat e panjohur kanë qenë me përqindje më të lartë në mesin e atyre që i kanë përdor gjilpërat dhe shiringat të përdorura më parë nga pjesëmarrësi.

Tabela 30. Shkëmbimi i gjilpërave, shiringave dhe paisjeve në muajin e fundit në mesin e PID, 2014

	N	%	95% CI	N	%	95% CI
	Prishtinë			Prizren		
Kanë shkëmbyer gjilpërën/shiringën (pjesëmarrësi e ka përdor atë pas dikujt tjetër)						
Po	60	13.8	9.3,17.2	9	2.7	0.5,4.6
Jo	236	86.1	82.7,90.7	190	97.2	95.3,99.4
Numri mesatar i personave që kanë përdor gjilpërën/shiringën para pjesëmarrësit (Min.-Max.)	1 (1-7)			1 (1-1)		
Afërsia me personin i cili e ka përdor gjilpërën/shiringën para pjesëmarrësit						
Shokë/të afërm	54	94.4	81.1,108	--	--	--
Familjarë/partner seksual	5	5.5	8.4,18.9	9	100	--
Ka injektuar drogë nga shiringa të cilën dikush tjetër ka asipuar drogën e tij/saj në shiringë						
Po	58	14.0	9.3,17.7	3	0.5	0.02,0.9
